



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 20 regjistër (JR)
Datë 17.10.2018

Nr. 12 i vendimit
Datë 29.05.2019

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Luan Daci	Relator
Ardian Hajdari	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– më datë 29.05.2019, ora 14:00, mori në shqyrtim në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Mia LHE Roessingh-Bakels, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 20/2018 (JR), datë 17.10.2018, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, prokurore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 48, datë 25.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 62, 63, 65 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, fillimisht në dhomë këshillimi dhe më pas në seancë gjyqësore publike, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar

të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), nuk dëgjoi konkluzionet përfundimtare të subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, pasi ajo u largua nga seancat gjyqësore publike, me vullnetin e saj, dhe e la gjykimin e çështjes në mungesë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Luan Daci, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) me vendimin nr. 48, datë 25.07.2018, ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, me funksion prokurore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, aktualisht e pezulluar”, bazuar në nenet 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin D, pikat 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikën 5 të nenit 55, germën “c”, pikën 1 të nenit 58, si dhe pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
2. Në përfundim të procesit administrativ të rivlerësimit, Komisioni ka arritur në konkluzionet lidhur me rivlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit si më poshtë.

2.1 Për pasurinë apartament te {***}, Durrës, “subjekti i rivlerësimit:

- i) ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit te {***}, si dhe mbi momentin e pagesës së tij;
- ii) ka paraqitur deklarime të pasakta dhe me përmbajtje të ndryshme nga sa rezulton nga të dhënat e kontratave të nënshkruara prej saj;
- iii) i ka dhënë Komisionit përgjigje të pavërteta, të ndryshme dhe kontradiktore me realitetin e fakteve të vërtetuara nga dokumentet dhe kontratat e nënshkruara prej saj;
- iv) nuk ka pasur mjaftueshëm burime financiare të ligjshme për të kryer pagesën e çmimit të apartamentit të mësipërm, sipas kontratës dhe deklaratës noteriale të datës 14.11.2011”.

2.2 Për pasurinë apartament në ish-rrugën “{***}”, Tiranë, “subjekti i rivlerësimit:

- i) ka kryer deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në lidhje me pagesin/t dhe kohën e pagesës së çmimit të blerjes së apartamentit në ish-rrugën “{***}” Tiranë;
- ii) ka paraqitur deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme në lidhje me formën e përfitimit të pasurisë si në pikën më lart, me përmbajtje të ndryshme dhe në kundërshtim nga sa rezulton nga kontrata e shitblerjes së datës 12.11.2013, e nënshkruar prej tij;
- iii) ka dhënë përgjigje ndaj pyetësorëve të Komisionit, të pavërteta, të ndryshme dhe kontradiktore me realitetin e fakteve të vërtetuara nga dokumentet dhe deklarinet periodike të bëra prej tij, në lidhje me periudhën e banimit në këtë apartament, si dhe kur ka deklaruar posedimin apo përdorimin e sendeve/pasurive të tjetërkujt;
- iv) ka bërë deklarime të pamjaftueshme përgjatë periudhës 2004-2012, pasi nuk ka deklaruar në ILDKPKI posedimin e vazhdueshëm të apartamentit në ish-rrugën “{***}” Tiranë”.

2.3 Për sa u përket likuiditeteve, nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të aftësive paguese, me të ardhura nga burime financiare të ligjshme, pasi dalin me bilance negative pesë vite, respektivisht: viti 2011 (-4.123.421 lekë); viti 2012 (-103.233 lekë); viti 2013 (- 3417.236 lekë) dhe viti 2015 (-108.064 lekë) dhe, për rrjedhojë, bilanci total i këtyre viteve del negativ (-7.823.954 lekë).

3. Kërkesat procedurale, me objekt përjashtimin e trupit gjykues të Komisionit, pezullimin e shqyrtimit, përjashtimin nga lista prioritare, të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni i ka vlerësuar të pabazuara në ligj dhe në prova, ndërkohë i ka lejuar të drejtën e informacionit dhe pajisjen me akte, specifikuara si më poshtë.
- i) Kërkesa datë 29.06.2018, me objekt përjashtimin e trupit gjykues të Komisionit, pasi u shqyrtua nga një tjetër trup gjykues, i shortuar sipas rregullores, u rrëzua si e pabazuar nga Komisioni dhe iu njoftua subjektit të rivlerësimit në datën 05.07.2018.
 - ii) Kërkesa e datës 03.07.2018, për të rimarrë 34 dokumente, të cilat ishin skanuar me përmbajtje mbrapsht dhe subjekti pretendonte se e kishte të pamundur t'i lexonte ato, u pranua nga Komisioni, duke e njoftuar të paraqitej në datën 09.07.2018 për tërheqjen e dokumentacionit në fjalë të fotokopjuar.
 - iii) Në lidhje me kërkesën e datës 03.07.2018, për shpjegime mbi ndryshimet e trupit gjykues të Komisionit nga momenti i shortimit e në vijim, sqarimet iu dërguan me *e-mail*-in e datës 06.07.2018.
 - iv) Në lidhje me kërkesën e datës 04.07.2018, për vënien në dispozicion të rezultateve të hetimit dhe të dokumentacionit në lidhje me kriterin e figurës dhe atë profesional, Komisioni e risqaroi se hetimi ishte mbyllur vetëm për kriterin e pasurisë, por gjithsesi i vuri në dispozicion raportet e vlerësimit të bëra nga institucionet respektive dhe e ftoi subjektin e rivlerësimit për t'i marrë ato, dhe subjekti i rivlerësimit i tërhoqi këto dokumente në datën 09.07.2018.
 - v) Në lidhje me kërkesën e datës 05.07.2018, për të riçelur procesin e rivlerësimit edhe për dy kriteret e tjera, Komisioni iu përgjigj se më parë kishte vlerësuar dhe vendosur që hetimi të mbyllej vetëm për kriterin e pasurisë.
 - vi) Kërkesa e datës 06.07.2018, me objekt përjashtimin e të gjithë trupit gjykues të Komisionit, pasi u shqyrtua nga një tjetër trup gjykues, i shortuar sipas rregullores, u rrëzua nga Komisioni, si e pabazuar në ligj dhe në fakte, dhe iu njoftua subjektit të rivlerësimit më datë 11.07.2018.
 - vii) Kërkesa e datës 07.07.2018, për identifikimin e provave dhe pyetjen e dëshmitarëve të listuar nga ana e subjektit të rivlerësimit, u refuzua nga Komisioni, bazuar në nenin 49 të ligjit nr. 84/2016, pasi e konsideroi identifikimin e fakteve, për të cilat kërkohej marrja e provave, jo në përputhje me faktet që ishin objekt rivlerësimi, dhe gjithashtu të parëndësishme për vendimmarrjen.
 - viii) Kërkesa e datës 10.07.2018, me objekt pezullimin e procesit të rivlerësimit, të shoqëruar me dokumentacion mbi aplikimin nga ana e subjektit në GjEDNj, nuk u pranua, pasi kjo rrethanë nuk përbënte shkak për pezullimin e procesit të rivlerësimit.
 - ix) Kërkesa e datës 13.07.2018, me objekt përjashtimin e trupit gjykues të Komisionit, për mungesë pavarësie, pasi u shqyrtua dhe u vlerësua nga një tjetër trup gjykues, u rrëzua nga Komisioni, si e pabazuar në ligj dhe në prova.
 - x) Kërkesa e datës 18.07.2018, me objekt përsëritjen e hetimit administrativ, pasi pjesërisht ai ishte kryer nga relatori i parë, që më pas ishte zëvendësuar, nuk u pranua nga Komisioni, pasi e gjeti të pabazuar në ligj dhe në fakte, dhe jo në përputhje me parimin e ekonomisë

gjqësore, dhe iu komunikua me *e-mail*-in e datës 19.07.2018. Gjithashtu, aktiviteti hetimor ishte verifikuar dhe zhvilluar më tej nga relatori zëvendësues, duke pasur ai të gjitha mundësitë dhe kohën për të konfirmuar apo modifikuar, nëse do të ishte rasti, çfarë ishte bërë më parë nga relatori i zëvendësuar.

- xi) Kërkesa tjetër e datës 18.07.2018, edhe një herë me objekt përjashtimin e trupit gjykues të Komisionit, për shkak të mohimit të mundësisë për të përgatitur mbrojtjen e saj, nuk u pranua nga Komisioni për shqyrtim, pasi ajo rezultoi me qëllim zvarritje të procesit të rivlerësimit dhe e ripërsëritur për të 4-tën herë, dhe iu komunikua me *e-mail*-in e datës 19.07.2018.

II. Rrethanat e çështjes

4. Znj. Rovena Gashi është subjekt rivlerësimi për shkak të funksionit të saj si prokurore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, bazuar në nenin 179/b, pika 4 e Kushtetutës, e cila përcakton: “Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*”. Subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi për shkak të zgjedhjes së saj si anëtare e Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi, në zbatim të nenit 284, pika 9 e ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, e cila përcakton: “Anëtarët e Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi i nënshtrohen rivlerësimit me përparësi”.

4.1 Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 përkatësisht deklaratën e pasurisë në datën 24.01.2017¹ pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.

Nga shkresa e ILDKPKI-së nr. {***} prot. datë 17.11.2017, me titull “Raporti lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi”, rezulton se:

- i) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;
- ii) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv) ka kryer deklaram të rremë; dhe
- v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

III. Procedura para Kolegjit të Posaçëm të Apelit

5. Kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 48, datë 25.07.2018, ka paraqitur ankim subjekti i rivlerësimit Rovena Gashi, duke kërkuar prishjen e këtij vendimi dhe shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave të subjektit të rivlerësimit Rovena Gashi prej Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), si dhe konfirmimin e saj në detyrën e Prokurores në Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë.

¹ Deklarata nr. indeksi {***}, datë 24.01.2017.

6. Ankuesja legjitimohet në aspektin personal dhe kohor², bazuar në nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ndërkohë që vendimi i Komisionit është i ankimueshëm dhe nuk bën pjesë në përjashtimin e neneve F, pika 2 dhe E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës.
7. Gjatë shqyrtimit të çështjes në Kolegj, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (në vijim “ONM”), nëpërmjet Vëzhgueses Ndërkombëtare i ka paraqitur trupit gjykues të Kolegjit një opinion³ dhe gjetje⁴ nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 14.03.2019
- 7.1 Vëzhguesja Ndërkombëtare ka dhënë opinionin se mospranimi, nga ana e Komisionit, të kërkesës për përjashtimin e trupit gjykues në Komision, datë 18.07.2018, nuk cilësohet si shkelje e rëndë procedurale, për më tepër që subjekti i rivlerësimit kishte të drejtë të përsëriste kërkesën në seancë publike, të drejtë të cilën ajo zgjodhi të mos e ushtronte dhe, si rrjedhojë, nuk është e nevojshme që Kolegji të vendosë për shqyrtimin e kësaj çështjeje në seancë gjyqësore publike.
- 7.2 Subjekti i rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, në ankim pretendoi që për periudhën 19.07.2018 - 02.08.2018 ka qenë me raport për paaftësi të përkohshme në punë, fakt ky që pretendoi ta provonte me raportin mjekësor të vendosur bashkëlidhur ankimit. Vëzhguesja Ndërkombëtare ka paraqitur gjetjen se ankuesja, së bashku me ankimin, ka paraqitur një raport mjekësor të lëshuar me datë 18.07.2018, me anë të të cilit tregohet sëmundja e saj për periudhën 19.07.2018 - 02.08.2018, por se ky raport nuk është paraqitur asnjëherë pranë Komisionit. Në vijim të gjetjes së mësipërme, Vëzhguesja Ndërkombëtare shprehet se në mungesë të një kërkesë për shtyrje para Komisionit, për shkak sëmundjeje nga ana e subjektit të rivlerësimit, ky i fundit nuk kishte arsye objektive që të mos zhvillonte seancën në kohën dhe datën e caktuar, edhe pse në mungesë të subjektit të rivlerësimit dhe/ose përfaqësuesit të tij ligjor. Vëzhguesja ka paraqitur edhe akte shkresore së bashku me gjetjen, si: i) kopje të fletës përkatëse të regjistrimit të protokollit të Komisionit, që tregon regjistrimin nr. {***}, datë 20.07.2018, nga znj. Rovena Gashi dhe z. D.G., në lidhje me “Deklaratën përmbyllëse”; ii) kopje të faqes së parë të “Deklaratës përmbyllëse”, datë 20.07.2018, protokolluar pranë regjistrimit të protokollit të Komisionit me nr. {***}, që tregon orën kur është paraqitur dokumenti, “9:11 ora”; iii) *e-mail*-in e datës 20.07.2018, ora 9:29 nga subjekti i rivlerësimit drejtuar adresës info@kpk.al, që përmban vetëm “Deklaratën përmbyllëse” dhe shkëmbimin e *e-mail*-eve ndërmjet Vëzhgueses Ndërkombëtare dhe Komisionit, datë 04.03.2019, ora 11:30.
8. Në seancën gjyqësore të datës 18.03.2019, në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, trupi gjykues i Kolegjit vendosi pranimin e gjetjes dhe të akteve bashkëlidhur në cilësinë e provës, bazuar në nenin 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016. Kjo dispozitë përcakton se gjetja e paraqitur në formën e një deklarate, dokumenti ose raporti i dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar, përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur. Trupi gjykues i Kolegjit, në dhomë këshillimi, vendosi me shumicë votash që gjetja e Vëzhgueses Ndërkombëtare të shqyrtohej në seancë publike për të shprehur qëndrimin e vet subjekti i rivlerësimit për këtë gjetje dhe për provat bashkëngjitur.

² Ankimi është regjistruar me nr. {***} prot., datë 27.09.2018, ndërkohë që vendimi nr. 48, datë 25.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, rezultoi i njoftuar në adresë të subjektit të rivlerësimit me anë të shkresës nr. {***} prot., datë 10.09.2018, dhe i dorëzuar me anë të postës në datën 13.09.2019.

³ Në lidhje me shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, në përputhje me pikën 1, germa “b” e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012.

⁴ Në lidhje me mungesën e dokumentit apo vërtetimit që provon shkaqet mjekësore për mungesën e subjektit në seancën e Komisionit, çka duhet ta kishte çuar trupin gjykues të Komisionit në shtyrjen e seancës.

8.1 Në përputhje me opinionin e Vëzhgueses Ndërkombëtare në lidhje me kërkesën e 4-t të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit për përjashtimin e trupit gjykues të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se kjo kërkesë ishte një përpjekje e qëllimshme për të vonuar seancën dhe, në përgjithësi, për të vonuar procesin e saj të rivlerësimit, sjellje e cila është mbajtur parasysht nga Kolegji, bazuar në nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

8.2 Në fakt, subjekti i rivlerësimit kishte objektivisht kohën/mundësinë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tij. Kjo provohet me faktin se që në mëngjesin e ditës së seancës dëgjimore, datë 20.07.2018, në Komision, znj. Rovena Gashi paraqiti një dokument të gjerë mbrojtjeje dhe nuk kërkoi shtyrjen e seancës as për shkak të arsyeve shëndetësore të pretenduara, as për shkak të afatit të shkurtër për të përgatitur mbrojtjen apo për të zgjedhur mbrojtës sipas ligjit, por as nuk e përsëriti kërkesën për përjashtim të trupit gjykues të Komisionit. Sipas gjetjes së Vëzhgueses Ndërkombëtare në lidhje me mosparaqitjen e subjektit të rivlerësimit në seancën publike në Komision, datë 20.07.2019, nuk përbënte shkak për shtyrjen e seancës gjyqësore, aq më tepër që nuk kishte një kërkesë të tillë nga subjekti i rivlerësimit për shtyrjen e seancës gjyqësore si për shkak të gjendjes shëndetësore, ashtu edhe për shkak të afatit të shkurtër kohor.

8.3 Siç vëren edhe Vëzhguesja Ndërkombëtare, kërkesa e 4-t e subjektit të rivlerësimit për përjashtim, mund të konsiderohet si abuzim nga ana e subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e të drejtave të saj procedurale. Sipas teoricienëve të procedurës civile, ka dy mënyra kryesore për të luftuar abuzimin me të drejtat procedurale, të cilat janë: a) nëpërmjet dispozitave të përgjithshme që parandalojnë abuzimin me të drejtën, sikurse dispozitave të mirëbesimit apo korrektësisë; ose b) zgjidhjeve të veçanta të lidhura me institutet individuale procedurale ku mund të ndodhë sjellja abuzive⁵. Ndonjëherë në procedurat civile përdoren edhe dispozita nga ligji material civil, si: mirëbesimi, zakonet e mira, ndalimi i abuzimit me të drejtën. Në legjislacionin administrativ nuk ka zakonisht dispozita të tilla të përgjithshme antiabuzive. Ato janë zhvilluar nga studiuesit dhe jurisprudenca në baza të ndryshme, ndonjëherë të marra nga legjislacioni civil origjinal, të trajtuara si parime të përgjithshme ligjore, të zbatuara për të gjitha fushat e ligjit⁶. Duhet të mbahet parasysht që neni 14 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim ligji nr. 49/2012) parashikon se të drejtat dhe detyrat e palëve rregullohen sipas dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurës Civile (në vijim “K.Pr.Civile”), për aq sa ato nuk bien ndesh me përmbajtjen e këtij ligji.⁷ Neni 100 i K.Pr.Civile përcakton se palët dhe përfaqësuesit e tyre kanë detyrimin që gjatë procesit gjyqësor të sillen me mirëbesim dhe ndershmëri. Trajtimi nga ana e Komisionit të kërkesës së 4-t për përjashtim, ishte një përgjigje e duhur ndaj sjelljes procedurale të subjektit të rivlerësimit, duke marrë parasysht parimet e mësipërme dhe përcaktimet e nenit 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016⁸. Për këtë arsye, ishte i

⁵ Shih Michele Taruffo, më sipër, shënimin në fund nr. 4, f. 6-7.

⁶ Duhet të mbahet parasysht se masat për të kundërvëpruar (kontrolluar) ndaj sjelljes abuzive gjatë procesit duhet të përdoren në mënyrën e duhur. Në fakt, masa të tilla mund të shihen si kufizime për të drejtën për (akses) gjykatë dhe si të tilla mund të vlerësohen nga këndvështrimi i pranueshmërisë së kufizimit të kësaj të drejte themelore. Nga praktika gjyqësore e GjEDNj-së, në lidhje me të drejtën për gjykatë, mund të nxirret përfundimi rreth domosdoshmërisë së trajtimit individual të çdo rasti dhe marrjen parasysht të veçantive të tij. Çdo trajtim automatik në përdorimin e instrumenteve për të luftuar sjelljen abuzive mund të ketë efektet e kundërta (shih Jerzy Parchomiuk më sipër, f. 7).

⁷ Për t'u shënuar se pika 2 e nenit 1 të ligjit nr. 49/2012 përcakton: “[...] Dispozitat e këtij ligji plotësohen me parashikimet e K.Pr.Civile, me përjashtim të rasteve dhe për aq sa ky ligj nuk parashikon ndryshe”.

⁸ Për më tepër, pika 1 e nenit 34 të K.Pr.Civile përcakton: “Gjykata, në çdo shkallë të gjykimin, kur konstaton se palët ose përfaqësuesit e tyre me vetëdije paraqesin padi, ankime, kërkesa ose pretendime abuzive, ose të përsëritura dhe me keqdashje, ose kur kërkojnë qëllimisht të zvarrisin gjykimin, ose kur konstatohet se palët ose përfaqësuesit e tyre kanë fshehur ose shtrembëruar me keqbesim ose faj

drejtë vendimi i Komisionit për ta konsideruar këtë kërkesë të 4-t në një periudhë prej tri javësh, si një përpjekje të qëllimshme për të vonuar seancën dhe, në përgjithësi, për të vonuar procesin e saj të rivlerësimit. Në fakt, subjekti i rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, kishte objektivisht kohën dhe mundësinë e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e saj. Gjithashtu, duke qenë se në mëngjesin e datës 20.07.2018, të seancës dëgjimore para Komisionit, ajo paraqiti një dokument të gjerë mbrojtjeje, kjo provon se shkak i kërkesës së saj të fundit për përjashtim nuk qëndronte, sikurse nuk qëndronte edhe pretendimi i mohimit të së drejtës për t'u mbrojtur.

9. Lidhur me formën e gjykimit, trupi gjykues i Kolegjit vendosi që bazuar në nenin 51, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 49/2012, të vijojë gjykimin e kësaj çështjeje në seancë publike, me qëllim për t'u shprehur subjekti i rivlerësimit për gjetjen e Vëzhgueses Ndërkombëtare dhe provat bashkëngjitur saj.
10. Kërkesën e paraqitur nga ankuesja, për t'u ndihmuar në gjykim në Kolegj nga znj. E.G. në cilësinë e ndihmëses, trupi gjykues i Kolegjit në seancën gjyqësore publike, datë 04.04.2019, vendosi të mos e pranojë dhe ftoi subjektin e rivlerësimit të zgjedhë një përfaqësues ligjor, nëse e vlerësonte të nevojshme, duke arsyetuar se Kolegji, sipas nenit F të Aneksit të Kushtetutës, është gjykata e vetme e procesit, ai nuk është organ publik në kuptim të ligjit nr. 44/2016, Kodi i Procedurave Administrative (në vijim “K.Pr.Administrative”) dhe për këtë arsye nuk gjen zbatim neni 39 i këtij ligji, lidhur me pozitën procedurale të ndihmësit.

10.1 Në vijim, trupi gjykues arsyetoi se Kolegji, për shqyrtimin e ankimeve të paraqitura pranë tij, zbaton nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, i parë ky i lidhur me nenin 4, pika 6 e po këtij ligji, si dhe nenin 1, pikën 2 të ligjit nr. 49/2012 dhe, për këto arsye, arriti në konkluzionin se subjektet e rivlerësimit, përfshirë edhe znj. Rovena Gashi, mund të mbrohen dhe përfaqësohen për shqyrtimin e ankimeve në Kolegj me përfaqësues ligjor, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 96 të K.Pr.Civile.

11. Për kërkesën e paraqitur nga ankuesja në seancën gjyqësore publike, datë 23.04.2019, me objekt pranimin e znj. E.G. në cilësinë e përfaqësueses ligjore gjatë gjykimit në Kolegj, kërkesë të cilën e bazonte në nenin 96, paragrafi 1, germa “b” e K.Pr.Civile, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se znj. E.G. është gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës⁹, fakt i cili përbën ndalim ligjor të shprehur sipas nenit 96, paragrafi 2, germa “ç” e K.Pr.Civile, në të cilën parashikohet ndalimi që një gjyqtar të jetë përfaqësues i palëve përpara një gjykate dhe, për këtë arsye, nuk e pranoi atë.
12. Në seancën gjyqësore publike, datë 06.05.2019, në lidhje me kërkesën e përsëritur të ankueses për të pasur si përfaqësuese ligjore znj. E.G., trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se kjo e fundit ishte ende gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe gëzonte statusin e magjistrates, pavarësisht deklaramit dhe kërkesës që znj. E.G. ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGJ”) dhe që u bë me dije nga ankuesja dhe, për këtë arsye, vlerësoi se kërkesa e paraqitur përsëri nuk plotësonte kushtet e nenit 96 të K.Pr.Civile, madje vlerësoi se ishte në kundërshtim të hapur me nenin 96, paragrafi 2, germa “ç” e K.Pr.Civile.

të rëndë, fakte dhe rrethana të rëndësishme që lidhen me çështjen, urdhëron me vendimin që jepet në përfundim të gjykimit, përveç kur në këtë Kod parashikohet ndryshe, gjobitjen e përgjegjësit në shumën nga 50.000 deri në 100.000 lekë. Kundër këtij vendimi le johet ankim sipas rregullave për vendimet përfundimtare ose jopërfundimtare, në varësi të llojit të vendimit që i jep fund gjykimit përkatës”. Ky është një shembull tjetër i trajtimit të bërë nga ligjvënësi përkundrejt sjelljeve abuzive procedurale.

⁹ Sipas deklaramit të znj. E.G. në seancën publike gjyqësore datë 04.04.2019.

12.1 Në çdo seancë gjyqësore publike të zhvilluar para Kolegjit, trupi gjykues i ka dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit që të gjente përfaqësuesin e duhur ligjor, duke i dhënë asaj kohë për ta bërë këtë, por ajo me vullnetin e saj të lirë hoqi dorë nga e drejta për t'u dëgjuar dhe për të dhënë shpjegime në seancën publike të Kolegjit. Gjithashtu, në lidhje me këtë kërkesë të përsëritur, trupi gjykues i Kolegjit, me vendim të ndërmjetëm argumentoi:

- i) Sipas nenit 65, pika 2 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”), dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar, dhe se dorëheqja i jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit, jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. Po kështu neni 65, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, përcakton se në raste të justifikuara me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.
 - ii) Nga deklarimi dhe kërkesa e paraqitur para kësaj gjykate, por edhe siç u shpjegua nga subjekti i rivlerësimit në këtë seancë, nuk rezulton të ketë një kërkesë të posaçme në përputhje me parashikimet e nenit 65, pika 3 e ligjit nr. 96/2016.
 - iii) Nëse do t'i referohemi me afate konkrete, se kur kjo kërkesë apo ky deklarim nga znj. E.G. do të prodhonte efekte të mbarimit të statusit të magjistratit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky afat, sipas parashikimeve të nenit 65, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, do të ishte 30 qershori 2019, ndërsa KLGj-ja do të duhej të shprehej deri më 14 korrik 2019. Nëse kërkesa e bërë nga znj. E.G. do të ishte e motivuar sipas parashikimeve të nenit 65, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, atëherë si dorëheqja, por edhe vendimmarrja e KLGj-së do të kishin efekte para afateve të parashikuara në nenin 65, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, duke i dhënë në këtë mënyrë mundësi subjektit të rivlerësimit të kishte si përfaqësuese ligjore në Kolegji, znj. E.G., por edhe Kolegjit që të garantonte zbatimin e parimit të ekonomisë gjyqësore gjatë gjykimit të tij.¹⁰
 - iv) Nga ana tjetër, sipas nenit 93 të K.Pr.Civile, subjekti i rivlerësimit është në kategorinë e personave të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, pra mund t'i kryejë vetë të gjitha veprimet procedurale, përveçse kur ligji parashikon ndryshe. Subjekti i rivlerësimit, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, nuk është në kategorinë e subjekteve që ka nevojë për t'u mbrojtur domosdoshmërisht me përfaqësues ligjor të caktuar nga shteti. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit çmoi të mos pranonte kërkesën e paraqitur në datën 06.05.2019 nga subjekti i rivlerësimit për t'u përfaqësuar në këtë proces nga znj. E.G., e cila është ende gjyqtare në Rrethin Gjyqësor Durrës, pasi kjo kërkesë ishte përsëri në kundërshtim të hapur me nenin 96, paragrafi i 2-të, germa “ç” e K.Pr.Civile.
13. Trupi gjykues i Kolegjit, në seancën publike datë 06.05.2019, vendosi të vijojë gjykimin në mungesë të subjektit të rivlerësimit, i gjendur në kushtet kur ky i fundit vullnetarisht u largua nga salla e gjykimit të Kolegjit të Apelit, gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore publike. Trupi gjykues i Kolegjit pasi relatoi opinionin dhe gjetjen e Vëzhgueses Ndërkombëtare, të cituar më sipër, vendosi të mbyllte shqyrtimin gjyqësor dhe të tërhiqej për të marrë vendimin përfundimtar, shpallja e të cilit u caktua në datën 29.05.2019.

¹⁰ Kërkesa për dorëheqje nga ana e znj. E.G. është regjistruar në KLGj me aktin nr. {***} prot., datë 03.05.2019.

13.1 Në periudhën pasi trupi gjykues i Kolegjit u tërhoq për bisedime për vendimmarrje deri në shpalljen e vendimit, pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesë¹¹ për përjashtimin e trupit gjykues të Kolegjit.

13.2 Kërkesa e subjektit të rivlerësimit është trajtuar nga 5 trupa gjyqësore të shortuara në Kolegji, duke pasur në konsideratë zbatimin e balancuar të parimit të paanësisë në gjykim, me atë të ushtrimit të funksionit nga Kolegji si gjykatë, për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve të tij. Gjithashtu, për shqyrtimin e kësaj kërkesë, Kolegji, bazuar në nenin 75 të K.Pr.Civile, ka garantuar gjykimin e saj me 5 trupa gjyqësore, në të cilat gjyqtari për të cilin kërkohet përjashtimi nuk ka qenë anëtar.

13.3 Trupat gjyqësore të shortuara për këtë kërkesë, me vendimet: 1) nr. {***}, datë 27.05.2019; 2) nr. {***}, datë 27.05.2019; 3) nr. {***}, datë 27.05.2019; 4) nr. {***}, datë 27.05.2019 dhe 5) nr. {***}, datë 27.05.2019, kanë vendosur rrëzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues të Kolegjit, të caktuar për shqyrtimin e ankimit kundër vendimit nr. 48, datë 25.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

IV. Shkaqet e ankimit

- 14.** Ankuesja e kundërshton vendimin përfundimtar të Komisionit, duke pretenduar se zbatimi i ligjit material është i gabuar dhe se janë kryer shkelje procedurale të atilla që e bëjnë vendimin të cenueshëm sipas ankueses, duke kundërshtuar njëkohësisht edhe vendimet e ndërmjetme të marra gjatë shqyrtimit të çështjes nga Komisioni, ndërkohë që ankimi dhe parashtresat para seancës gjyqësore janë paraqitur së bashku me akte që kërkohet të merren si prova.

A. Pretendime për zbatimin e gabuar të ligjit material

- 15. Pasuria apartament te “{***}”, Durrës**

15.1 Sipas subjektit të rivlerësimit:

- i) kjo pasuri është blerë me kontratën e shitblerjes me rezervë ligjore nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 6.10.2011, prej shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK, ku ortak dhe përfaqësues

¹¹ Kërkesa nr. {***} prot., datë 10.5.2019, me objekt: “Përjashtimin e trupës gjyqësore të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të përbërë nga gjyqtarët Albana Shtylla, Luan Daci, Ardian Hajdari, Rezarta Schuetz dhe Sokol Çomo, nga shqyrtimi i ankimit të subjektit të rivlerësimit Rovena Gashi, Prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë, kundër vendimit me nr. 48, datë 25.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, dhe bazë ligjore “nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nenet 4, 7, 17, 42, 179/b pikat 2, 5, 6 dhe 10 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni C, pikat 3 dhe 16, neni Ç, pika 2, neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 2, datë 18.1.2017, vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 78, datë 12.12.2017, vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 5.4.2013, neni 4, pikat 5 dhe 6, neni 5, pikat 1 dhe 2, neni 12, pika 1, neni 13, germa “d”, neni 15, neni 16, pikat 12 dhe 16, neni 17, pika 1, germa “b”, neni 22, pikat 1 dhe 4, neni 23, pika 2, neni 27, neni 45, neni 47, neni 49, pikat 1, 2, 4, 6, 9, 10 dhe 11, neni 52, neni 55, pika 5, neni 65, pika 1, neni 66, pika 1, germa “c” te ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, neni 30, germa “h”, neni 31, pikat 3 dhe 4, nenet 35, 38, 39 dhe 40 të ligjit nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, neni 1, pika 2, neni 2, pikat 9 dhe 10, neni 3, pikat 1 dhe 4, neni 14, 47, 51, pika 1, germa “a”, neni 53, germa “c”, neni 54, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”, neni 55, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nenet 4, 6, 10, 11, 12, 14, 18, 20, 22, 23, 24, 28, 29, 38, 72 par. 1, pikat 4 dhe 6, neni 74, neni 75, neni 90, neni 96 par. 1, germa “b”, neni 96, par. 3, neni 98, neni 123, neni 125, neni 126, neni 145, 146, neni 148, neni 149, neni 171/b par., neni 172, neni 175, neni 176, neni 179, neni 180, neni 182, neni 183, neni 187, neni 192, neni 213, neni 214, neni 224/a, neni 224/b, neni 224/c, neni 224c, neni 224/d, neni 225, neni 226, neni 227, neni 229, neni 231, neni 233, neni 234, neni 236, neni 237, neni 297, germa “a”, neni 302, neni 303, neni 304, neni 305, neni 306, neni 307, neni 309, neni 461, neni 464, neni 465, neni 465/a, pika 3 dhe neni 467 i Kodit të Procedurës Civile, neni 6, neni 64, neni 65, neni 70, neni 71, neni 76, neni 79 dhe neni 80 i Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 1, datë 31.10.2019, vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 1/2018, datë 11.6.2018”.

- ligjor, në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate, ka qenë z. O.U., kunati i subjektit të rivlerësimit (bashkëshorti i motrës);
- ii) është paguar vetëm shumën prej 45.000 eurosh, pasi pjesa tjetër e çmimit në shumën prej 35.000 eurosh, i është bërë zbritje preferenciale nga kunati O.U., ndërsa burimi i krijimit të shumës prej 45.000 eurosh është kredi bankare (banka “{***}”);
 - iii) edhe sikur të pranojmë se kjo kontratë furnizimi me ujë është hapur për herë të parë në korrik të vitit 2011 dhe se data e hapjes për herë të parë përcakton momentin e fillimit të posedimit efektiv të këtij apartamenti nga ana e subjekti të rivlerësimit, atëherë si mund të ushtrohet efektivisht ky posedim, pra banimi, kur në apartamentin e banimit nuk ka pasur energji elektrike pasi, sipas informacionit të OShEE ShA, kontrata për furnizimin me energji të këtij apartamenti rezulton të jetë hapur për herë të parë në datën 27.10.2011;
 - iv) OShEE ShA ka konfirmuar se procedurat për hapjen dhe lidhjen për herë të parë të shërbimit të furnizimit me energji elektrike për apartamentet e banimit dhe njësitë e shërbimit në këtë godinë janë kryer nga ana e shoqërisë ndërtuese dhe më pas është bërë ndryshimi i emrit të abonentit nga shoqëria të blerësit konkretë;
 - v) kredia e disbursuar në datën 21.12.2011 nuk mund t’i llogaritet subjektit të rivlerësimit si shpenzim me vlerë 45.000 euro në vitin 2011, pasi kjo kredi është marrë me një afat shlyerjeje prej 357 muajsh.

16. Pasuria, apartament në ish-rrugën “{***}”, Tiranë

16.1 Sipas subjektit të rivlerësimit:

- i) për blerjen e kësaj pasurie nëpërmjet kontratës së porosisë datë. 28.10.2004, nga {***} ShPK dhe z. T.M., babai i subjektit të rivlerësimit (z. N.G.) ka kryer shitjen me anë të kontratës datë 16.4.2004 me të gjithë arredimin, mobiliet dhe elektroshtëpiaket në çmimin prej 10.000.000 lekësh, apartamentin e banimit në katin e gjashtë të shtesës anësore të bërë pa leje, në pallatin me nr. {***}, në lagjen nr. {***}, rruga {***}, Durrës, vëllait të tij z. H.G.;
- ii) dorëzimi i apartamentit dhe pagesa e plotë e çmimit është kryer në datën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes;
- iii) palët e interesuara dhe të përfshira në marrëdhënien juridike me këtë send, që ishin shoqëria ndërtuese, investitori, blerësi dhe përfituesit e apartamentit, kanë nënshkruar deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 2.11.2013, që përfaqëson aktin me të cilin u formalizua dhurimi;
- iv) nuk vërtetohet kryerja e asnjë pagese për këtë apartament banimi shoqërisë së ndërtimit apo investitorit, z. T.M., nga ana znj. Rovena Gashi dhe z. D.G., në datën e lidhjes së kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.11.2013;
- v) z. N.G., në cilësinë e blerësit, nëpërmjet deklaratave noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.9.2018, dhe nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.9.2018, konfirmon lidhjen e kontratës së porosisë në datë 28.10.2004;
- vi) Komisioni nuk ka asnjë kompetencë konstatimi të pavlefshmërisë së veprimeve juridike apo kontratave të cilat janë lidhur me vullnet të lirë dhe të plotë ndërmjet palëve, kanë formën e kërkuar nga ligji, kanë sjellë pasojat juridike të dëshiruara prej palëve, nuk janë bërë objekt kundërshtimi gjyqësor apo jashtëgjyqësor prej palëve apo të tretëve që mund të kenë pretendime mbi të njëjtin send;
- vii) ligji nuk kërkon formën me akt noterial të kontratës së porosisë dhe se mungesa e formës me akt noterial të kësaj kontrate nuk sjell pavlefshmërinë e saj;

- viii) në lidhje me mosdeklarimin asnjëherë ndër vite qysh nga viti 2005 deri në momentin e blerjes në vitin 2013, nuk ka pasur asnjë detyrim për të deklaruar në deklaratën *vetting* pasuritë e tjetërkujt;
- ix) procesi i rivlerësimit nuk konsiston në krahasimin e deklaratave të pasurisë ndër vite të subjektit të rivlerësimit me deklaratën *vetting* dhe as në verifikimin e deklarimeve të subjektit në deklarata periodike vjetore;
- x) pyetësi nr. {***} i Komisionit është një akt procedural i pavlefshëm dhe antiligjor, pasi detyra në kuadër të procesit të rivlerësimit është të verifikojë përputhshmërinë ndërmjet asaj që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting* me atë që rezulton nga gjendja e akteve dhe jo të provokojë dhe të detyrojë subjektin e rivlerësimit të bëjë deklarime të reja për çështje të tjera që nuk përfshihen në objektin e verifikimit.

B. Pretendime për shkelje procedurale

17. Subjekti i rivlerësimit parashtron pretendime për shkelje procedurale, si më poshtë:

17.1 Sipas subjektit të rivlerësimit:

- i) ILDKPKI-ja ka tejkalar kompetencat, pasi ka paraqitur akt përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, i cili nuk përfaqëson një raport me të dhëna ndihmëse për organet e rivlerësimit, por një sugjestionim negativ, ndërkohë që duhet të përgatiste një raport në lidhje me saktësinë dhe plotësinë e deklaratës, si dhe ligjshmërinë e pasurisë së deklaruar, në formën e një vlerësimi paraprak dhe jo përfundimtar;
- ii) Komisioni i ka hequr të drejtën për t'u njohur, për të dhënë shpjegime dhe për të paraqitur prova në mënyrë të barabartë me subjektet e tjera të rivlerësimit që në këtë fazë paraprake mbi nivelin e shtrirjes së verifikimit, në lidhje me rrethin e personave, ndaj të cilëve është shtrirë verifikimi, në lidhje me pasuritë, mbi të cilat është shtrirë verifikimi;
- iii) z. N.G. nuk është person i lidhur;
- iv) në asnjë dispozitë materiale apo procedurale të ligjit nr. 84/2016, nuk i jepet një definicion juridik personit tjetër të lidhur, si subjekt mbi të cilin duhet të shtrihet verifikimi dhe kontrolli në sistemin e rivlerësimit;
- v) në asnjë aspekt, lidhja e gjakut të subjektit të rivlerësimit Rovena Gashi me të atin, N.G., nuk mund të konsiderohet as si lidhje interesi që rrjedh nga një marrëdhënie tjetër biznesi;
- vi) vlerësimi i pronave të babait të saj apo bërja e llogarive mbi nivelin e konsumit apo të shpenzimeve, si dhe e bilancit të të ardhurave dhe shpenzimeve, për periudhën nga viti 1993 deri në datë 30.12.2016, bie në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë së veprimit së organeve pjesëmarrëse në sistemin e rivlerësimit;
- vii) në mungesë të konfirmimit të marrëdhënies së interesit pasuror apo të biznesit prej z. N.G. dhe të një kërkesë me shkrim drejtuar atij prej Inspektorit të Përgjithshëm, ku t'i kërkohej të deklaronte pasurinë dhe t'i jepej mundësia të paraqiste aktet dhe dokumentet në lidhje me gjendjen e pasurive e të të ardhurave, ILDKPKI-ja nuk kishte të drejtë të kryente verifikime, kontrolle e aq më tepër të arrinte në konkluzione mbi ligjshmërinë e pasurisë së tij;
- viii) analiza dhe vlerësimi në mënyrë krejt të kundërt i të njëjtave akte dhe arritja e konkluzioneve tërësisht kontradiktore, për të njëjtat pasuri, mbi bazën e të njëjtave dokumente, të kryera

nga i njëjti institucion, për të njëjtin subjekti rivlerësimi, përbën cenim të parimit të barazisë para ligjit nga ana e ILDKPKI-së.

17.2 Sipas subjektit të rivlerësimit:

- i) Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së është zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë në datën 20.02.2014, me shumicë të thjeshtë të votave të deputetëve të mazhorancës parlamentare;
- ii) Prokurorja e Përgjithshme e Përkohshme e Republikës së Shqipërisë, e zgjedhur vetëm me votat e kësaj mazhorance politike, e shkarkoi subjektin e rivlerësimit Rovena Gashi nga funksioni i Drejtoreshës së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë dhe Dekriminalizimit, pikërisht për shkak të kërkesës së vetë subjektit të rivlerësimit, drejtuar KQZ-së, për heqjen e mandatit për deputetët e Kuvendit A.R. dhe G.R.;
- iii) ekzistojnë dyshime legjitime për sa i përket mungesës së pavarësisë objektive të Inspektorit të ILDKPKI-së ndaj urdhrave, qëndrimeve apo tendencave të forcës politike që e zgjedhi në këtë detyrë, në raport me vetë subjektin e rivlerësimit, për sa kohë që ai ka vepruar në emër të vet personal si Inspektor i Përgjithshëm dhe nuk ka vepruar në emër të ILDKPKI-së si institucion i pavarur dhe për sa kohë që akti i kontrollit të plotë dhe përfundimtar i Inspektorit të Përgjithshëm, për efekt rivlerësimi, në lidhje me subjektin e rivlerësimit Rovena Gashi, është kontradiktor me aktin e kontrollit dhe të rikontrollit të plotë, të ushtruar vetëm disa muaj më parë nga ILDKPKI-ja si institucion, ndaj të njëjtit subjekt rivlerësimi, për të njëjtat pasuri dhe mbi bazën e të njëjtave dokumente;
- iv) tregues i mungesës së paanësisë së Inspektorit të Përgjithshëm dhe ILDKPKI-së në raport me vetë subjektin e rivlerësimit është edhe fakti që, për marrëdhënie juridike të ngjashme që edhe subjekte të tjera rivlerësimi kanë krijuar me shoqëri tregtare, nuk është mbajtur i njëjti qëndrim e nuk është zbatuar i njëjti standard provueshmërie e vlerësimi, si në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi.

17.3 Sipas subjektit të rivlerësimit:

- i) për sa kohë që vazhdon procesi i rivlerësimit, ndaj subjektit të rivlerësimit nuk mund të ndërmerret asnjë procedurë tjetër administrative, civile apo penale, që ka të bëjë me trajtimin dhe vlerësimin e çështjeve, të pasurisë, të pastërtisë së figurës apo të aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, dhe vetëm pas përfundimit me sukses të procesit të rivlerësimit, prokurori i nënshtrohet sistemit të përhershëm të llogaridhënies, ndërkohë që me urdhrin nr. {***}, datë 29.12.2017, Prokurorja e Përgjithshme e Përkohshme ka urdhëruar lirim të prokurores në Prokurorinë e Përgjithshme Rovena Gashi nga detyra e Drejtoreshës së Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë;
- ii) i vetmi organ që gjatë procesit kalimtar të rivlerësimit dhe vetëm në përfundim të tij, ka të drejtë të vendosë pezullimin e subjektit të rivlerësimit për çështje të pasurisë, të pastërtisë së figurës dhe të aftësive profesionale është Komisioni Pavarur i Kualifikimit.

17.4 Sipas subjektit të rivlerësimit, kryerja e veprimeve prej komisioneres Suela Zhegu për një periudhë 4-mujore, në lidhje me vetë subjektin e rivlerësimit, në kushtet e konfliktit të hapur dhe real të interesit, veprime dhe akte këto me rëndësi thelbësore e përcaktuese në këtë proces, pavarësisht nga dhënia e dorëheqjes shumë të vonuar prej saj, jo vetëm që nuk e shkarkon këtë komisionere si person zyrtar nga përgjegjësia ligjore disiplinore, por sjell si pasojë edhe

pavlefshmërinë absolute të akteve, të veprimeve dhe të procedurave të kryera nga ana e trupit gjykues të Komisionit, anëtare e të cilit ka qenë edhe kjo komisionere.

17.5 Sipas subjektit të rivlerësimit, marrja e dy masave të karakterit disiplinor nga ana e Prokurores së Përgjithshme të Përkohshme të Republikës së Shqipërisë, si dhe regjistrimi i një procedimi penal, për të cilin vazhdojnë ende hetimet, përbëjnë pengesë për të për vazhdimin e qenies anëtare dhe ushtrimin e kompetencave të saj në KED, dhe shkak që Komisioni ta përjashtonte nga lista e subjekteve prioritare, me rivlerësim të menjëhershëm.

17.6 Sipas subjektit të rivlerësimit:

- i) trupi gjykues i Komisionit i pamundësoi subjektit të rivlerësimit ushtrimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe pjesëmarrjen reale, efektive të saj në seancë dëgjimore;
- ii) trupi gjykues i Komisionit i ka mohuar asaj të drejtën e mbrojtjes, për sa kohë që është totalisht e pamundur që të mund të realizohet mbrojtja brenda një dite e gjysmë, ndaj një hetimi 7-mujor, gjatë të cilit ka vepruar me iniciativë dhe vetëm kryesisht organi administrativ, për më tepër në kushte të mospranimit prej këtij organi të 38 (tridhjetë e tetë) provave të kërkuara nga ana e subjektit të rivlerësimit;
- iii) caktimi formalisht i seancës dëgjimore, datë 20.07.2018, për subjektin e rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, i pamundësoi paraqitjen realisht asaj në këtë seancë.

17.7 Sipas subjektit të rivlerësimit:

- i) vendimi i Komisionit është shpallur në datën 25.07.2018, ndërkohë që i është komunikuar subjektit të rivlerësimit në datën 13.09.2018, pra 50 ditë pas shpalljes dhe, për këtë arsye, i është cenuar e drejta për akses, pasi ka vonuar të drejtën e ushtrimit të ankimit;
- ii) shpallja e vendimit nuk mund të shtyhet, ndërkohë që ajo nuk u shpall në fund të seancës dëgjimore, datë 20.07.2018, por në seancën dëgjimore datë 25.07.2018, dhe subjekti i rivlerësimit nuk u njoftua për këtë seancë, duke iu mohuar e drejta për t'u dëgjuar.

17.8 Sipas subjektit të rivlerësimit, në kushtet e pamundësisë së subjektit për t'u paraqitur personalisht, nga datat 19.07.2018 - 02.08.2018, sipas raportit për paaftësi të përkohshme nr. {***}, datë 18.7.2018, Komisioni duhet t'i caktonte subjektit një përfaqësues kryesisht.

17.9 Sipas subjektit të rivlerësimit, dhënia e vendimit dhe nënshkrimi i vendimit prej relatorit Lulzim Hamitaj, në kushtet e mosplotësisë prej tij të kriterëve kushtetuese dhe ligjore për të qenë gjyqtar i institucionit të rivlerësimit për shkak të përdorimit të dokumenteve të falsifikuara, për të cilin është regjistruar procedim penal dhe, për këtë arsye, i ka cenuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për proces dhe instancën e parë gjyqësore gjatë procesit të saj të rivlerësimit.

17.10 Sipas subjektit të rivlerësimit, Vëzhguesja Ndërkombëtare nuk i garanto:

- i) të drejtën për t'u njohur me përbërjen e trupit gjykues të Komisionit;
- ii) të drejtën për t'u rivlerësuar mbi të tria kriteret e këtij procesi dhe për një hetim të drejtë, të plotë dhe të pavarur, pasi lejoi që hetimi të mbyllej vetëm mbi bazën e akteve që kishte mbledhur relatorja që dha dorëheqjen;
- iii) mosndërhyrjen e pushtetit ekzekutiv gjatë procesit të rivlerësimit, pasi kontrolli i figurës u krye vetëm nga DSIK-ja;
- iv) ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave dhe mospërhapjen e informacionit dhe nuk kërkoi fillimin e procedimit disiplinor ndaj komisionarëve që shkelën këtë detyrim;

- v) mundësinë e ushtrimit të barrës së provës, pasi lejoi këtë trup gjykues të Komisionit të mos pranonte asnjë nga 38 provat e kërkuara;
- vi) të drejtën e një përfaqësuesi ligjor në seancë dëgjimore;
- vii) qëndroi indiferente ndaj 5 kërkesave të subjektit të rivlerësimit për përjashtim të trupit gjykues të Komisionit dhe ndaj vendimeve të padrejta të kësaj trupe gjykuese;
- viii) lejoi që vendimi të jepej dhe të nënshkruhej nga një person që nuk i plotësonte kushtet për t'u caktuar komisioner dhe për të vazhduar detyrën;
- ix) nuk mori asnjë masë për të shuar dyshimet e subjektit të rivlerësimit mbi mungesën e pavarësisë së saj në këtë mision kushtetues.

17.11 Sipas subjektit të rivlerësimit:

- i) nuk është identifikuar në pjesën hyrëse dhe në dispozitivin e vendimit detyra e subjektit të rivlerësimit, për të cilën hyri në rivlerësim me përparësi dhe trupi gjykues i Komisionit nuk është mjaftuar me tregimin e emrit dhe të identitetit të subjektit të rivlerësimit;
- ii) mosnjohja prej trupit gjykues të Komisionit, minimalisht e detyrës së subjektit të rivlerësimit, është tregues i mungesës së pavarësisë së këtij trupi gjykues dhe i shkeljes së detyrimeve kushtetuese për trajtimin me dinjitet të subjektit të rivlerësimit;
- iii) mosidentifikimi i dispozitave ligjore konkrete i ka cenuar të drejtën për proces, duke i kufizuar ushtrimin e së drejtës së ankimit.

17.12 Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, asaj i është dhënë mundësia të paraqesë prova dhe të japë shpjegime vetëm pas mbylljes së hetimit administrativ si dhe në seancë dëgjimore, ndërkohë që Komisioni nuk i ka pranuar asnjë nga provat e kërkuara, për të cilat i kishte kaluar barrën e provës.

17.13 Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, moskryerja e procesit të rivlerësimit mbi të tria kriteret, si dhe mospranimi i kërkesës së saj për t'u zhvilluar hetim administrativ prej Komisionit edhe për dy kriteret e tjera të procesit të rivlerësimit, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, e bëjnë antikushtetues procesin e rivlerësimit të këtij subjekti dhe ia mohojnë asaj në thelb të drejtën e ankimit.

17.14 Sipas subjektit të rivlerësimit:

- i) Komisioni, nëpërmjet *e-mail*-it, i ka bërë të ditur subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, se paraqitja prej saj e kërkesave procedurale do të merret parasysh nga Komisioni në vlerësimin përfundimtar të subjektit si pengesë, zvarritje dhe mungesë bashkëpunimi prej saj;
- ii) asnjë kërkesë procedurale e subjektit të rivlerësimit nuk është e përsëritur dhe paraqitja e kërkesave procedurale është e drejtë themelore e subjektit pjesëmarrës.

17.15 Sipas subjektit të rivlerësimit:

- i) nuk është e vërtetë që nuk ka paraqitur prova dhe nuk ka dhënë shpjegime brenda afatit të caktuar nga Komisioni, por e vërteta është që provat e kërkuara nuk u pranuan, duke u caktuar seanca dëgjimore, pa i dhënë mundësinë të japë shpjegime mbi bazën e provave;
- ii) ushtrimi i barrës së provës nuk mund të realizohet, duke iu rrëzuar të gjitha provat e kërkuara;
- iii) shpjegimet për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht nuk mund të jepen pa provat e kërkuara nga subjekti i rivlerësimit;

iv) nuk është e vërtetë që nuk i kundërshtoi në vetvete faktet e konstatuara nga Komisioni.

17.16 Sipas subjektit të rivlerësimit:

- i) z. N.G. ka vetëm cilësinë e dhuruesit të shtëpisë së banimit të vajzës së tij dhe Komisioni ishte i detyruar t'i kërkonte konfirmonte marrëdhënien juridike të dhurimit me vajzën e tij;
- ii) Komisioni duhet t'i kishte dhënë mundësinë që të justifikonte ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së dhuruar vajzës së tij;
- iii) Komisioni duhet ta kishte shtrirë verifikimin vetëm rreth mundësive ekonomike për blerjen e këtij apartamenti banimi në vitin 2004, dhe jo të bënte përpjekjen e dështuar për të justifikuar shtrirjen e këtij hetimi ndaj z. N.G., për periudhën nga viti 1990 - 31.12.2016, me argumentin se është person i lidhur, sepse ka kryer pagesat për shkollimin e fëmijëve të subjektit të rivlerësimit, çka përbën totalisht shpërdorim të detyrës nga ana e trupit gjykues të Komisionit, ndërkohë që deklaratimet e subjektit të rivlerësimit rreth masës së shpenzimeve të kryera prej saj për shkollimin e fëmijëve janë konfirmuar plotësisht nga institucionet arsimore përkatëse dhe janë vërtetuar edhe nga Komisioni gjatë hetimit administrativ të kryer prej tij.

17.17 Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi:

- i) ajo mund të shkarkohet nga detyra atëherë kur të ketë bërë deklaratime të pamjaftueshme për dy kritere njëkohësisht, atëherë kur rezulton se ka bërë deklaratime të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të figurës dhe për kriterin e pasurisë;
- ii) deklaratimet e pamjaftueshme vetëm rreth kriterit të pasurisë nuk përbëjnë shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit;
- iii) referimi i Komisioni për këtë shkarkim të neni 59, pika 1, germa "a" e ligjit nr. 84/2016, është i gabuar pasi: "niveli i besueshëm në vlerësimin e pasurisë" sipas përcaktimeve të këtij neni është kriter konsiderimi së bashku me kriteret e tjera.

C. Kundërshtimi i vendimeve të ndërmjetme

18. Së bashku me vendimin përfundimtar, ankuesja kundërshton vendimet e ndërmjetme të Komisionit, sikurse dhe mungesën e vendimmarrjes nga ana e Komisionit.

18.1 Në lidhje me vendimin e datës 20.06.2018¹² të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas të cilit trupi gjykues i caktuar për të kryer rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit ka vendosur: "1) Mospranimin e kërkesës më datë 18.6.2018, të znj. Rovena Gashi, në lidhje me përjashtimin e saj nga lista prioritare e subjekteve të rivlerësimit, pasi nuk ka bazë ligjore që të legjitimojë subjektin e rivlerësimit për këtë kërkesë dhe që t'i diktojë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për të hequr një subjekt nga lista prioritare, si dhe për faktin që procedura e hetimit administrativ është në fazën konkluzive dhe për ekonomi procedurale nuk mund të pranohet

¹² Në dosje është administruar njëkohësisht edhe vendimi i datës 20.06.2018 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pjesa urdhëruese e të cilit rezulton si në vijim: "1) Të mos pranojë kërkesën e znj. Rovena Gashi, pasi hetimi administrativ tashmë ishte programuar pikërisht për vendimmarrjen mbi mbylljen e këtij hetimi dhe për njoftimin e subjektit të rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit. 2) Të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Rovena Gashi bazuar në relacionin paraprak (bashkëlidhur si Aneksi 1) të paraqitur nga relatori i çështjes. 3) Të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, sipas dokumentit bashkëngjitur si Aneksi 2, në bazë të paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; 4) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga KPK-ja, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative, sipas dokumentit bashkëlidhur si Aneksi 3. 4) Të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarinin e konfliktit të interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta. [...]".

kërkesa në fjalë. 2) Të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, bazuar në relacionin paraprak (bashkëlidhur si Aneksi 1, të paraqitur nga relatori i çështjes. 3) Të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit (sipas dokumentit bashkëngjitur si Aneksi 2), në bazë të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. 3) Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga KPK-ja në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe neneve 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative (sipas dokumentit bashkëngjitur si Aneksi 3). 4) Të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit si edhe brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta. [...]” – subjekti i rivlerësimit parashtron shkaqet si më poshtë:

- i) kompetente ishte Mbledhja e Komisionerëve;
- ii) është i falsifikuar sepse ka dy vendime të ndryshme për të njëjtën kërkesë procedurale;
- iii) masat disiplinore të uljes në detyrë, të pezullimit nga detyra dhe regjistrimi i një procedimi penal para përfundimit të procesit të rivlerësimit përbëjnë pengesë për vazhdimin e ushtrimit të kompetencave në Këshillin e Emërimeve në Drejtësi (në vijim “KED”).

18.2 Në lidhje me vendimin e datës 04.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas të cilit trupi gjykues i caktuar për të shqyrtuar kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit ka vendosur: “1) Mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, për përjashtimin e trupës gjykuese, si të pabazuar në ligj dhe në prova [...] pasi subjekti i rivlerësimit kishte kërkuar përjashtimin e komisionerëve Genta Tafa (Bungo), Lulzim Hamitaj dhe Pamela Qirko nga procesi i rivlerësimit,” subjekti i rivlerësimit parashtron shkaqet si më poshtë:

- i) kompetente ishte Mbledhja e Komisionerëve;
- ii) trupi gjykues i caktuar për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit e ka justifikuar me programimin e marrjes së një vendimi në lidhje me hetimin, i cili për më tepër ishte paracaktuar për të qenë një vendim për mbylljen e hetimit administrativ, ende pa u marrë një vendim i tillë;
- iii) nuk ka dhënë garancitë e duhura mbi paanësinë, barazinë para ligjit, objektivitetin dhe proporcionalitetin, duke krijuar dyshime të arsyeshme e të bazuara në prova mbi paragjykimin në thelb të çështjes prej saj, nëpërmjet rëndimit padrejtësisht të pozitës së subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ e ka shtrirë hetimin administrativ si dhe ka bërë analizë financiare për z. N.G.

18.3 Në lidhje me vendimin e datës 06.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas të cilit trupi gjykues i caktuar për të kryer rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit ka vendosur: “1) Në lidhje me kërkesën nr. {***} prot., datë 29.06.2018, subjektit të rivlerësimit i është vënë në dispozicion vendimi i trupit gjykues që e shqyrtoi atë. Ky vendim i është dërguar me anë të postës dhe i është njoftuar me *e-mail*-in e datës 05.07.2018 nëpërmjet adresës zyrtare {***}. 2) Në lidhje me kërkesën nr. {***} prot., datë 03.07.2018, të ftohet subjekti i rivlerësimit për t’u paraqitur pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ditën e hënë, datë 09.07.2018, në orarin 11:30 - 17:00, për të tërhequr fotokopjet e 34 dokumenteve të kërkuara. 3) Subjekti i rivlerësimit mund t’i paraqesë shpjegimet deri në datën 13.07.2018, në orën 17:00. 4)

Në lidhje me kërkesën nr. {***} prot., datë 03.07.2018, të informohet subjekti i rivlerësimit për faktin se, bazuar në rregulloren “Për procedurat e hedhjes së shortit në KPK”, trupi gjykues i zgjedhur për shqyrtimin e kërkesës për dorëheqje, të paraqitur nga komisionere Suela Zhegu, ka vendosur zëvendësimin e saj më një tjetër komisioner. Në lidhje me kërkesën nr. {***} prot., datë 04.07.2018, trupi gjykues ka përmbyllur hetimin administrativ dhe i ka kaluar barrën e provës subjektit në lidhje me kriterin pasuror. Raportet e vlerësimit për dy kriteret e tjera do t'i vihen subjektit në dispozicion. Në lidhje me vendimin e datës 06.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, subjekti i rivlerësimit parashtron shkaqet si më poshtë.

- i) Njohja e subjektit të rivlerësimit mbi përfundimin e procedurave të hetimit për tri kriteret e procesit të rivlerësimit, ishte një e drejtë e subjektit të rivlerësimit.
- ii) Njohja e subjektit të rivlerësimit me kopjen e dokumentacionit të administruar nga ana e Komisionit mbi të tria kriteret e procesit të rivlerësimit, ishte një e drejtë e subjektit të rivlerësimit.
- iii) Në fakt, në datën 09.07.2018, Komisioni i ka vënë në dispozicion subjektit raportin e DSIK-së dhe të Prokurorit të Përgjithshëm dhe jo raportet mbi rezultatet e hetimit të kryera nga Komisioni në lidhje me kriterin e figurës dhe profesionalizmit të subjektit të rivlerësimit;
- iv) Mosaplikimi i standardeve, parimeve, procedurave dhe metodologjive të barabarta me subjektet e tjera të përfshira në të njëjtën procedurë vlerësimi, i ka cenuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për proces të rregullt ligjor, duke minuar në thelb procesin e tij të rivlerësimit.

18.4 Në lidhje me vendimin e datës 11.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas të cilit trupi gjykues i caktuar për të shqyrtuar kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, ka vendosur: “1) Të rrëzojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, për përjashtimin e trupit gjykues si të pabazuar në ligj dhe në prova [...], pasi subjekti i rivlerësimit kishte kërkuar që kjo trupë gjykuese nuk duhet të kishte vazhduar procesin e rivlerësimit ndaj subjektit, por duhet të ishte përjashtuar”, subjekti i rivlerësimit parashtron shkaqet si më poshtë.

- i) Mosnjoftimi i përbërjes së trupit gjykues të caktuar për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit dhe të relatorit, menjëherë pas hedhjes së shortit, i ka mohuar të drejtën subjektit të rivlerësimit për të parashtruar ekzistencën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues të caktuar për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, para fillimit të hetimit administrativ ndaj tij.
- ii) Nuk ka asnjë shans ligjor që konfirmimi në detyrë i subjektit të rivlerësimit të bëhet bazuar vetëm në një kriter dhe, në kushtet kur rezultojnë se të gjitha subjektet e rivlerësimit, për të cilat Komisioni ka vendosur të hetojë vetëm mbi kriterin e pasurisë, janë shkarkuar më pas dhe, për këto arsye, kërkonte përjashtimin e komisionerëve Genta Tafa (Bungo), Lulzim Hamitaj dhe Pamela Qirko, pasi trupi gjykues i subjektit të rivlerësimit e kishte paragjykuar çështjen, duke paracaktuar vendimin për të, shumë kohë më parë para përfundimit të procesit të rivlerësimit të këtij subjekti.
- iii) Në cilësinë e relatores së këtij trupi gjykues ka qenë komisionerja Suela Zhegu, e cila ka vepruar në kushtet e konfliktit të hapur të interesit me subjektin e rivlerësimit, ndërkohë që ky trup gjykues i ka dhënë subjektit të rivlerësimit të drejtën për të ngritur pretendime mbi ekzistencën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues, vetëm nëpërmjet njofimit

datë 26.06.2018, pas marrjes së vendimit për mbylljen e një hetimi administrativ të zhvilluar prej komisioneres Suela Zhegu.

18.5 Në lidhje me vendimin e datës 09.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas të cilit trupi gjykues i caktuar për të kryer rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit ka vendosur: “1) Të mos pranojë kërkesën nr. {***} prot., datë 09.07.2018, të subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, në zbatim të pikës 6, geramat “b”, “c”, “ç”, “d” të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi provat e kërkuara kërkojnë si të panevojshme në funksion të vendimmarrjes [...] pasi subjekti i rivlerësimit kishte kërkuar marrjen e gjithsej 38 (tridhjetë e tetë) provave në kuadër të ushtrimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit parashtron shkaqet si më poshtë.

- i) Brenda afatit ligjor të caktuar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesën me shkrim, duke identifikuar provat shkresore mbështetëse që i ka kërkuar të pyeten në cilësinë e dëshmitarëve mbi kriterin e pasurisë.
- ii) Ka kërkuar marrjen e informacionit nga institucione shtetërore, të shoqëruar me dëftesat për pranimin e objekteve postare, si dhe nga subjekte të tjera për z. N.G. dhe znj. E.G., me vetë subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur, z. D.G., të pyetet në cilësinë e dëshmitarit personi tretë i lidhur, z. N.G., dhe persona të tjerë të tretë.

18.6 Në lidhje me vendimin e datës 11.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas të cilit trupi gjykues i caktuar për të kryer rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit ka vendosur: “1) Të mos pranojë kërkesën me nr. {***} prot., datë 10.07.2018, të subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, pasi është e pabazuar në ligj dhe në prova [...], pasi subjekti i rivlerësimit kishte kërkuar pezullimin e shqyrtimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar prej GjEDNj-së, në lidhje me këtë çështje paraprake”, subjekti i rivlerësimit parashtron se në kërkesën dhe aplikimin e datës 26.06.2018, subjekti i rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, ka pretenduar para GjEDNj-së shkelje flagrante të së drejtës së saj për proces të rregullt ligjor, të garantuar prej nenit 6 të KEDNj-së prej komisionerëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit gjatë kryerjes së procedurave dhe zhvillimit të hetimit administrativ në ngarkim të saj.

18.7 Në lidhje me vendimin e datës 17.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, sipas të cilit trupi gjykues i caktuar për të shqyrtuar kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, ka vendosur: “1) Rrëzimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, për përjashtimin e trupës gjykuese si të pabazuar në ligj dhe në prova, pasi subjekti i rivlerësimit kishte kërkuar përjashtimin e trupës gjykuese të përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Lulzim Hamitaj dhe Pamela Qirko, për mungesë të pavarësisë së kësaj trupe gjykuese gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit”, subjekti i rivlerësimit parashtron shkaqet si më poshtë.

- i) Trupi gjykues i Komisionit nuk ka qenë i pavarur, pasi nuk ka marrë masa për ushtrimin e kompetencave të tij në përputhje me normat kushtetuese dhe vendimin nr. 2, datë 18.01.2017, të Gjykatës Kushtetuese, duke mos garantuar respektimin e parimit të ndarjes dhe të balancimit ndërmjet pushteteve, me qëllim parandalimin e ushtrimit të kompetencave ligjore në mënyrë të pakontrolluar nga ana e DSIK-së.
- ii) Nuk ka kryer vetë hetim të pavarur në lidhje me kriterin e figurës së subjektit të rivlerësimit, nuk ka kryer as verifikim dhe as ka ushtruar kontroll mbi rezultatet paraprake dhe jo të detyrueshme të organit ndihmës, DSIK-së.

- iii) Funkzioni i DSIK-së ka përfunduar para hedhjes së shortit dhe fillimit të procesit të rivlerësimit prej KPK-së, me përjashtim të subjektit të rivlerësimit.

18.8 Në lidhje me vendimin e datës 19.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, trupi gjykues i caktuar për të shqyrtuar kërkesën për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit, ka informuar subjektin e rivlerësimit se për sa i përket kërkesës me nr. {***} prot., datë 18.07.2018, për përsëritjen e hetimit, pasi u shqyrtua e konsideroi të pabazuar në fakte dhe në ligj, pasi procesi i hetimit administrativ i kryer nga relatorja e mëparshme, është vlerësuar, verifikuar dhe plotësuar nga procesi i mëtejshëm hetimor nga relatori, z. Hamitaj dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohen të cenuara hetimet, që në tërësinë e tyre u janë përmbajtur të gjitha dispozitave ligjore përkatëse, ndërsa në lidhje me kërkesën nr. {***} prot., datë 18.07.2018, trupi gjykues ka vlerësuar se kjo kërkesë nuk mund të pranohet, pasi ajo rezulton e përsëritur dhe me tendencë zvarritjeje të procesit të rivlerësimit, fakt që do të të duhet të mbahet parasysh në vlerësim, pasi subjekti i rivlerësimit me këto dy kërkesa kishte kërkuar përsëritjen e hetimit dhe përjashtimin e trupit gjykues, duke parashtruar shkaqet si më poshtë.

- i) Procedurat e hedhjes së shortit për përcaktimin e trupit gjykues të subjektit të rivlerësimit janë zhvilluar në datë 30.11.2017.
- ii) Komisionerja Suela Zhegu është caktuar në përbërje të trupit gjykues dhe relatore e procesit të rivlerësimit që në datë 30.11.2017.
- iii) Vendimi i ndërmjetëm për kufizimin e hetimit administrativ të Komisionit ndaj subjektit të rivlerësimit vetëm mbi kriterin e pasurisë është marrë në muajin dhjetor të vitit 2017 nga trupi gjykues i Komisionit, në përbërje të të cilit dhe në cilësinë e relatores ka qenë komisionerja Suela Zhegu, e cila ka vepruar në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit, shkak për të cilin është përjashtuar më pas nga procesi i rivlerësimit të këtij subjekti.
- iv) Përjashtimi i komisioneres relatore, znj. Suela Zhegu, nga trupi gjykues i procesit të rivlerësimit të subjektit Rovena Gashi, për shkak të ekzistencës së situatës së konfliktit të interesit me të, ka ndodhur në datë 15.03.2018, kohë në të cilën subjekti i rivlerësimit ka denoncuar këtë situatë konflikti interesi tek ONM-ja, duke ia bërë të ditur njëkohësisht edhe vetë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
- v) Rezulton se i gjithë hetimi administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit, i kufizuar vetëm në kriterin e pasurisë, është kryer prej trupit gjykues të Komisionit, në përbërje të të cilës ka qenë komisionerja relatore Suela Zhegu, e cila ka vepruar në kushtet e ekzistencës së situatës së konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
- vi) Rezulton se vendimi për shtrirjen e hetimit administrativ të Komisionit mbi kriterin e pasurisë, edhe ndaj babait të subjektit të rivlerësimit, si një rast i paprecedentë në të gjitha praktikatat e rivlerësimit, nga viti 1990 deri në datën 23.12.2016, për një shtëpi banimi me vlerë 38800 USD, të dhuruar subjektit të rivlerësimit në vitin 2005, është marrë nga trupi gjykues i Komisionit në kohën kur në përbërje të tij ka qenë komisionerja Suela Zhegu, e cila ka pasur rolin e relatores së këtij trupit gjykues dhe ka vepruar në kushtet e ekzistencës së situatës së konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit. Nëpërmjet mospranimit të asnjërës prej 38 provave të kërkuara nga ana e subjektit të rivlerësimit, ky trup gjykues, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka hequr asaj mundësinë e ushtrimit efektiv të detyrimit të barrës së provës.
- vii) Komisioni i ka mohuar subjektit të rivlerësimit të drejtën e hetimit të plotë dhe të gjithanshëm e të barabartë me subjekte të tjera të rivlerësimit.

viii) Ky trup gjykues i ka hequr subjektit të rivlerësimit të drejtën për një mbrojtje efektive dhe sipas një afati të arsyeshëm në seancë dëgjimore, pasi afati i dhënë prej një ditë e gjysmë, nuk mund të konsiderohet as një afat i mjaftueshëm për zgjedhjen e një mbrojtësi e as afat i arsyeshëm për përgatitjen e mbrojtjes.

18.9 Në lidhje me mungesën e vendimmarrjes për kërkesën e datës 07.08.2018, me të cilën kërkohej konstatimi i pavlefshmërisë absolute të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i datës 25.7.2018, dhënë nga trupi gjykues i komisionerëve Genta Tafa (Bungo), Pamela Qirko, Lulzim Hamitaj, subjekti i rivlerësimit parashtron shkaqet si më poshtë.

- i) Në datën 30.7.2018, Prokuroria e Përgjithshme ka njoftuar publikisht fillimin e hetimeve ndaj komisionerit publik Lulzim Hamitaj, për verifikimin e denoncimit publik të përdorimit të dokumenteve të falsifikuara prej tij, që kanë të bëjnë me plotësimin e kriterëve për të qenë komisioner në KPK.
- ii) Fakti kriminal i denoncuar në media rreth komisionerit Lulzim Hamitaj, që ka të bëjë me mosplotësimin prej tij të kushteve dhe kërkesave kushtetuese dhe ligjore për të qenë komisioner, me përdorimin prej tij të certifikatës së falsifikuar për sa i përket mbrojtjes së gjuhës së huaj, falsifikimin prej tij të CV, formularëve dhe të akteve, në lidhje me kualifikimin në gjuhën e huaj, të dorëzuara pranë organeve shtetërore dhe që janë marrë në konsideratë e kanë shërbyer për zgjedhjen e tij.

19. Ankuesja, së bashku me ankimin e paraqitur, ka kërkuar shqyrtimin në themel dhe marrjen e provave të reja, me pretendimin se është refuzuar marrja e këtyre akteve nga Komisioni, se ishte e pamundur paraqitja para Komisionit për shkak të afatit, dhe se në përmbajtje këto prova të reja që kërkohet të merren janë akte zyrtare dhe përmbajnë fakte shumë të rëndësishme dhe të domosdoshme për sqarimin e çështjeve. Subjekti i rivlerësimit së bashku me parashtrësit¹³ e datës 13.03.2019, ka paraqitur gjithashtu akte të tjera që ka kërkuar të merren si prova.

V. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Në lidhje me pretendimet për zbatimin e gabuar të ligjit material

20. Procedura e kontrollit të pasurive është shtrirë në drejtim të ligjshmërisë së burimeve për blerjen dhe deklarimin e përdorimit të apartamentit me sipërfaqe 105 m², të ndodhur në {***}, Durrës, dhe të apartamentit me sipërfaqe 121 m², të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, si dhe të rezultateve financiare të subjektit të rivlerësimit.

20.1 Pasuria apartament te “{***}”, Durrës

- i) Nga “Deklarata e pasurisë për procesin e rivlerësimit, nr. indeksi {***}, datë 24.01.2017”, shprehimisht rezulton e deklaruar: “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit - Apartament në zonën e {***} me sipërfaqe 105 m², me nr. pas. {***}, e regjistruar në ZVRPP Durrës, në shumën 80000 euro. Blerë nga kompania “{***}”, me kontratën e shitblerjes me rezervë ligjore nr. {***}, datë 06.10.2011, në bashkëpronësi me bashkëshortin 50%. Burimi kredi në bankën “{***}” 45000 euro dhe 35000 euro trajtim preferencial nga O.U., bashkëshorti i motrës së subjektit Rovena Gashi. Regjistruar në emër të Rovena Gashit dhe D.G., me

¹³ Regjistruar në Kolegjin e Apelit me nr. {***} prot., datë 13.03.2019.

sipërfaqe 105 m², zk {***}, nr. pas. {***}, vol. {***}, f. {***}, Durrës. Adresa: lagjja {***}, {***}, Durrës. Vlera me shifra dhe me fjalë: 80.000 (tetëdhjetë mijë) euro; pjesa në % - 50%. Përshkrimi i detyrimeve: Kredi marrë në bankën “{***}” me qëllim blerje apartamenti në Durrës, me nr. {***}, datë 19.12.2001, në shumën 46214 euro, me afat 357 muaj. Vendosur si kolateral apartamenti i blerë, me sipërfaqe 105 m², nr. pas. {***}, në Durrës. Kredimarrës D.G. dhe bashkëkredimarrëse Rovena Gashi. Shuma e principalit të papaguar 41978 euro. Interesa të papaguar në shumën 12341 euro. Kësti mujor: 246 euro. Principali i paguar: në shumën 3236 euro. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer deri në datën e fillimit të rivlerësimit: vlera e mbetur e kredisë deri në datë 16.01.2017 është 41979 euro (dyzet e një mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë).”

- ii) Nga “Deklarata e interesave privatë, periodikë/vjetorë, nr. indeksi {***}, datë 29.03.2011”, shprehimisht rezulton e deklaruar: “Përshkrimi i pasurisë dhe burim i krijimit: Blerë një apartament në zonën e {***}, me nr. {***}, k. {***}, sipërfaqe ndërtimi 105 m², me strukturë 2+1, emërtuar pas. nr. {***}, regjistruar në hipotekën e ZVRPP Durrës, në shumën 80000 mijë euro nga kompania “{***}”. Me këtë kompani është lidhur kontrata e shitblerjes me rezervë ligjore, bërë me aktin noterial nr. {***}, datë 06.10.2011 (noter M.Rr., Durrës). Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë: Marrë një kredi prej 45000 mijë eurosh nga banka “{***}” në datën 19.12.2011. Nuk është shlyer asnjë këst gjatë vitit 2011. Dhurata dhe trajtime preferenciale: Pjesa prej 35000 eurosh për blerjen e një apartamenti të përshkruar në f. {***} të këtij formulari është zbritje nga çmimi, duke u konsideruar si një trajtim preferencial nga z. O.F.U., bashkëshorti i motrës sime.”
- iii) Nga vërtetimi hipotekor nr. {***}, datë 07.12.2011, lëshuar nga ZVRPP Durrës, vërehet se pasuria nr. {***}, zk {***}, me sip. 105 m², me adresë lagjja {***}, {***}, apartament nr. {***}, shk. {***}, kt. {***}, dupleks, figuron e regjistruar në pronësi të Rovena Gashi, D.G., me origjinë regjistrimi nr. hip. {***}, datë 24.12.2009, pa barrë mbi pasurinë.
- iv) Nga kontrata e kredisë bankare dhe hipotekore nr. {***} rep., {***} kol., datë 19.12.2011, vërehet lidhja e kontratës për kredi nga banka “{***}” ShA, në shumën 45214 euro për blerje shtëpie, sipas kontratës së shitblerjes të një pasurie të paluajtshme me rezervë ligjore nr. {***} rep., {***} kol., datë 06.10.2011, dhe njëkohësisht hipotekimin e kësaj pasurie për këtë shkak.
- v) Nga vërtetim hipotekimi i pasurisë së paluajtshme të ZVRPP Durrës, sipas kërkesës nr. {***}, datë 21.12.2011, vërehet se kjo pronë është inskriptuar me nr. {***}, datë 21.12.2011, në favor të bankës “{***}”, inskriptim i parë mbi këtë pronë.
- vi) Nga kontrata e shitblerjes së një pasurie të paluajtshme me rezervë ligjore nr. {***} rep., {***} kol., datë 06.10.2011, vërehet se këstin e parë në shumën 30000 euro, pala blerëse deklaroi se e ka parapaguar *cash* dhe jashtë zyrës (noteriale), gjë e cila pranohet me deklaram para noterit dhe nga pala shitëse; ndërsa këstin e dytë dhe të fundit në shumën 50000 euro, pala blerëse pranon ta paguajë brenda datës 30.11.2011, duke u dokumentuar pagesa me transfertë bankare dhe e shoqëruar me deklaratën noteriale të nënshkruar nga të dyja palët.
- vii) Nga deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.11.2011, vërehet se në ekzekutim të kontratës së shitblerjes me rezervë ligjore nr. {***}, datë 06.10.2011, pala shitëse “{***}” ShPK pranon se nga ana e palës blerëse, bashkëshortët znj. Rovena Gashi

dhe z. D.G., në datë 14.11.2011, i janë dorëzuar në *cash* dhe jashtë zyrës edhe kësti i dytë dhe i fundit i çmimit të shitjes në shumën 7.023.500 lekë.

- viii) Nga fatura e shitjes së ujit dhe largimit të ujërave të ndotura, datë 05.08.2011, nr. serie {***}, e Ujësjetës Kanalizime ShA Durrës, për muajin korrik, viti 2011, klienti D.G., me adresë: {***}, lagjja {***}, Durrës, vërehet totali i faturës në shumën 185,5 lekë, i ndarë në zërat: uji i harxhuar (45,0 lekë); kanalizimi (9,6 lekë); tarifa e shërbimit (100,00 lekë); TVSh (30,9 lekë).
- ix) Nga shkresa e OShEE, kthim përgjigje nr. {***} prot, datë 12.01.2018, vërehet se me gjeneralitete D.G. identifikohet, ndër të tjera, edhe kontrata e furnizimit me energji elektrike {***}, {***}, datë hapje 27.10.2011
- x) Të analizuar në tërësi, vërehet se ka mospërputhje midis deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe fakteve që rezultojnë nga aktet më lart.
- xi) Përkundër sa parashtron subjekti i rivlerësimit, përdorimi i sendit duhet të ketë filluar në kohën kur vërtetohet se ka filluar konsumi i ujit të pijshëm dhe përfitimi i shërbimeve të tjera nga UKT Durrës, që përkon me posedimin efektiv të sendit. Komisioni në përfundimet e arritura është bazuar në provat shkresore, në kuptim të nenit 246 të Kodit të Procedurës Civile, me fuqi provuese të marrëdhënies kontraktore të përfitimit të shërbimeve përkatëse, provë e cila i është drejtuar subjektit të rivlerësimit në drejtim të barrës së provës. Për vërtetësinë e kësaj shkrese nuk është ngritur pretendim sipas ligjit dhe, nga ana tjetër, marrëdhënia kontraktore që ajo dëshmon, është e vlefshme dhe e pakundërshtuar.
- xii) Për sa u përket akteve të fitimit të pronësisë, pasojat që ato sjellin analizohen në drejtim të respektimit të dispozitave urdhëruese ligjore. Sipas vërtetimit hipotekor të lëshuar nga ZVRPP Durrës, kjo pasuri është regjistruar në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, e lirë nga çdo pretendim i shitësit, ndërkohë që në një kohë të mëpasshme subjekti i rivlerësimit së bashku me personin e lidhur kanë lidhur kontratën e kredisë dhe kanë paguar në favor të shitësit këstin e dytë. Komisioni në përfundimet e arritura është bazuar në aktin noterial për tjetërsim të pasurisë së paluajtshme dhe në veprimin noterial të përmbushjes së detyrimeve sipas marrëveshjes kontraktore. Bazuar në nenin 68 të ligjit nr. 7829, datë 1.9.1994, “Për noterinë”, pavlefshmëria e aktit ose e veprimit noterial mund të kërkohet nga personat që kanë marrë pjesë në hartimin e tij dhe nga çdo person që heq të drejta e merr përsipër detyrime prej tyre dhe kërkesa shqyrtohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, në territorin e së cilës e ushtron veprimtarinë zyra noteriale që ka kryer këto akte a veprime noteriale. Në kushtet kur nuk ka as kundërshtim, sipas ligjit, të akteve dhe veprimeve noteriale, as rregullim të pasojave që ato kanë sjellë, këto akte/veprime noteriale janë fuqiplota për atë çka dëshmojnë. Në rastin konkret dëshmohet shlyerja e plotë e shumave objekt kontrate dhe kalimi i pronësisë mbi këtë send të paluajtshëm para marrjes së kredisë.

20.1.1 Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë dhe të paplotë këtë pasuri të paluajtshme, bazuar në përcaktimet e nenit D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe subjekti i rivlerësimit, ndryshe nga sa parashikohet në këtë bazë ligjore në nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe, sipas rezultateve të analizës financiare të vitit 2011, ka pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht dhe nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave për të fituar këtë pasuri, siç përcaktohet

në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

20.2 Pasuria apartament në ish-rrugën “{*}”, Tiranë**

- i. Nga deklarata e pasurisë për procesin e rivlerësimit, nr. indeksi {***}, datë 24.01.2017, shprehimisht rezulton: apartament banimi me sipërfaqe 121 m², me nr. pas. {***}, në zk {***}, vol. {***}, f. {***}, me adresë në rrugën “{***}”, ose “{***}”, sipas certifikatës së pronësisë nr. {***}, datë 22.06.2012, burimi, dhuruar nga babai i Rovena Gashit me deklaratë noteriale nr. {***}, datë 02.11.2013, regjistruar në pronësi të D.G. dhe Rovena Gashi, apartamenti me sipërfaqe 121,36 m², zk {***}, vol. {***}, f. {***}.
- ii. Nga deklarata e interesave privatë periodikë/vjetorë, nr. indeksi {***}, datë 31.03.2014, shprehimisht rezulton: përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit: apartament banimi me sip. ndërtimi 137,5 m², ndodhur në k. {***}, në rrugën “{***}”, nr. {***}, ky apartament ka nr. pas. {***}, ndodhur në zk {***}, vol. {***}, f. {***}, me sipërfaqe totale 121,36 m², me adresë në rrugën “{***}” (“{***}”), kjo sipas certifikatës për vërtetim pronësie nr. {***}, lëshuar nga ZRPP Tiranë, datë 22.06.2012, dhuruar nga babai i deklartuesit me deklaratë noteriale, i cili e ka poseduar këtë pronë që prej vitit 2004; pjesa në % - 50 %; dokumente justifikuese: kontratë shitje pasurie të paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.11.2013, 5 (pesë) fletë; deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.11.2013, 2 fletë; certifikatë për vërtetim pronësie nr. {***}, e lëshuar në datën 20.11.2013 nga ZRPP Tiranë, 2 fletë; kartelë e pasurisë së paluajtshme 3 (fletë).
- iii. Nga certifikata për vërtetim pronësie e datës 20.11.2013, e lëshuar nga ZVRPP Tiranë, vërehet se figuron e regjistruar në zk {***}, pas. nr. {***}, vol. {***}, f. {***}, me adresë në rrugën “{***}”, në pronësi të znj. Rovena Gashi dhe të z. D.G., me shënimin kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.11.2013.
- iv. Nga deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.11.2013, vërehet se është deklaruar se z. N.G., pasi ka rregulluar të gjitha marrëdhëniet financiare me investitorin T.M., ka vendosur të heqë dorë nga pronësia e apartamentit dhe t’ia dhurojë atë vajzës së tij, Rovena Gashi, dhe bashkëshortit të saj, D.G.
- v. Nga kontrata e porosisë e datës 28.10.2004, ndërmjet {***} ShPK, z. T.M. dhe z. N.G., me objekt, porosi për blerjen e një apartamenti të përbërë nga këto mjedise: me sipërfaqe ndërtimi 137,5 m², sipërfaqe shfrytëzimi 107,59 m², ndodhur në katin e 14 teknik. Me marrëveshje të përbashkët të palëve, çmimi i shitjes është caktuar 38800 USD, shumë kjo që është likuiduar nga blerësi N.G. në favor të shitësit, investitorit T.M. Pjesa u likuidua totalisht në momentin e nënshkrimit të kontratës. z. T.M. dhe z. N.G. kanë vendosur që të prishin kontratën e datës 18.10.2004 të lidhur që rregullon marrëdhëniet financiare ndërmjet tyre para nënshkrimit të kësaj kontrate.
- vi. Nga vërtetimi i nënshkrimit nr. {***}, datë 2.11.2013, vërehet se {***} ShPK, e përfaqësuar nga administrator z. A.B., z. T.M. dhe nga ana tjetër z. N.G., deklaruan se më datë 28.10.2004, kanë nënshkruar një kontratë porosie për një apartament të porositur nga z. N.G.
- vii. Nga kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.11.2013, znj. Rovena Gashi dhe z. D.G. kanë lidhur me shoqërinë ndërtuese {***} ShPK dhe investitorin T.M. kontratën sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.11.2013, për blerjen e pasurisë së

sipërcituar, dhe se Rovena Gashi dhe D.G. i kanë likuiduar totalisht investitorit T.M. çmimin e shitjes prej 38800 USD, të vendosur për apartamentin e mësipërm përpara regjistrimit në ZVRPP Tiranë dhe jashtë zyrës noteriale.

- viii. Nga shkresa e OShEE ShA, kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 12.01.2018 (6 faqe), vërehet se në emër të z. D.G. rezulton, ndër të tjera, edhe kontrata e furnizimit me energji elektrike: {***} D.G., {***}, {***}, pall. {***}, datë hapjeje 18.11.2004.
- ix. Nga shkresa e Ujësjiellës Kanalizime Tiranë ShA, kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 10.01.2018, vërehet se klienti D.G., me nr. kontrate {***}, kategoria familjare {***}, rruga “{***}”, datë hapjeje 31.10.2004, nuk ka pasur konsum dhe nuk ka kryer pagesa për muajt nëntor 2004 - prill 2005; ka pasur konsum, por nuk ka kryer pagesa për muajt maj 2005 - nëntor 2005; nuk ka pasur konsum dhe nuk ka kryer pagesë për muajin dhjetor 2005; ka pasur konsum për muajt janar 2006 - qershor 2010, por pagesa për të gjithë këtë periudhë është kryer në datën 31.7.2010; ka pasur konsum në muajt korrik 2010 - nëntor 2017 dhe pagesat janë kryer sipas muajve.
- x. Të analizuar në tërësi rrethanat faktike, vërehet se ka mospërputhje midis deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe fakteve që rezultojnë nga aktet më lart.
- xi. Përkundër sa parashtrohet ankuesi, përdorimi i sendit ka filluar në kohën kur vërtetohet se ka filluar konsumi i energjisë elektrike nga OShEE ShA, që përkon me posedimin efektiv të sendit. Komisioni, në përfundimet e arritura, është bazuar në provat shkresore, në kuptim të nenit 246 të Kodit të Procedurës Civile, me fuqi provuese të marrëdhënies kontraktore të përfitimit të shërbimeve përkatëse, provë e cila i është kundërdrejtuar subjektit të rivlerësimit në drejtim të barrës së provës. Për vërtetësinë e kësaj shkrese, nuk është ngritur pretendim sipas ligjit dhe, nga ana tjetër, marrëdhënia kontraktore që ajo dëshmon, është e vlefshme dhe e pakundërshtuar, sot e kësaj dite. Ankuesi pretendon se ka filluar ta përdorë këtë pasuri të paluajtshme në vitin 2006, por në të vërtetë për këtë vit kanë filluar të bëhen pagesat për konsum uji të pijshëm, për të cilin kontrata është regjistruar në datën 31.10.2004
- xii. Për sa u përket akteve të fitimit të pronësisë, pasojat që ato sjellin analizohen në drejtim të respektimit të dispozitave urdhëruese ligjore dhe konditave të nevojshme për lidhjen dhe qenien e kontratës. Bazuar në nenin 663 të Kodit Civil, kushtet e nevojshme për qenien e kontratës janë: pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin, shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi, objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji.
- xiii. Përkundër sa subjekti i rivlerësimit pretendon, kontrata (me shkresë të thjeshtë) e datës 28.10.2004, ndërmjet {***} ShPK, z. T.M. dhe z. N.G., nuk është kontratë porosie dhe as sipërmarrjeje, por kontratë shitjeje e një sendi të paluajtshëm në të ardhmen, për të cilën ligji kërkon akt noterial. Bazuar në nenin 660 të Kodit Civil, palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosur nga legjislacioni në fuqi dhe, bazuar në nenin 681, kur interpretohet një kontratë, duhet të sqarohet se cili ka qenë qëllimi i vërtetë dhe i përbashkët i palëve, pa u ndalur në kuptimin literal të fjalëve, si dhe duke vlerësuar sjelljen e tyre në tërësi, para e pas përfundimit të kontratës. Në bazë të neneve 705 dhe 706 të Kodit Civil, të cilat përcaktojnë se kontrata e shitjes ka për objekt kalimin e pronësisë së një sendi ose kalimin e një të drejte kundrejt pagimit të një çmimi, dhe në shitjen që ka për objekt fitimin në të ardhmen të një sendi ose të një të drejte, fitimi i pronësisë bëhet sapo sendi ose

e drejta pranohet se ekzistojnë. Qëllimi i palëve ka qenë shitja e kësaj pasurie kur sendi të fitonte ekzistencën e tij sipas ligjit. Neni 750 i Kodit Civil përcakton se shitja e sendeve të paluajtshme kryhet sipas mënyrave të parashikuara në nenin 83 të këtij kodi, përndryshe është e pavlefshme, ndërsa neni 83 i Kodit Civil përcakton se veprimi juridik për kalimin e pronësisë së sendeve të paluajtshme dhe të të drejtave reale mbi to, duhet të bëhet me akt noterial dhe të regjistrohet, përndryshe nuk është i vlefshëm dhe se është i pavlefshëm veprimi juridik që nuk është bërë në formën e kërkuar shprehimisht nga ligji.

- xiv. Për sa u përket akteve të fitimit të pronësisë, kjo pasuri është regjistruar në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, e lirë nga çdo pretendim i shitësit, bazuar në kontratën e shitjes. Komisioni, në përfundimet e arritura, është bazuar në aktin noterial për tjetërsim të pasurisë së paluajtshme dhe në veprimin noterial të përmbushjes së detyrimeve, sipas marrëveshjes kontraktore. Bazuar në nenin 68 të ligjit nr. 7829, datë 01.09.1994, “Për noterinë”, pavlefshmëria e aktit ose e veprimit noterial mund të kërkohej nga personat që kanë marrë pjesë në hartimin e tij dhe nga çdo person që heq të drejta e merr përsipër detyrime prej tyre dhe kërkesa shqyrtohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, në territorin e së cilës e ushtron veprimtarinë zyra noteriale që ka kryer këto akte a veprime noteriale. Në kushtet e moskundërshtimit, sipas ligjit dhe rregullimit të pasojave që kontrata e shitjes ka sjellë, ajo është fuqiptotë për atë çka dëshmohej. Në rastin konkret, dëshmohej shlyerja e plotë e shumave objekt kontrate dhe kalimi i pronësisë mbi këtë send të paluajtshëm sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.11.2013. Për sa i përket referimit në kontratën e porosisë, datë 28.10.2004, neni 111 i Kodit Civil përcakton se kur shkaku i pavlefshmërisë prek vetëm një pjesë të veprimit juridik, ky mbetet i vlefshëm në pjesët e tjera të tij, përveç kur, sipas përmbajtjes së veprimit juridik, këto pjesë paraqesin marrëdhënie të pandashme me pjesën e pavlefshme të veprimit juridik.

20.2.1 Për sa më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë dhe të paplotë këtë pasuri të paluajtshme, bazuar në përcaktimet e nenit D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe, sipas rezultateve të analizës financiare të vitit 2013, ka pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht dhe nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave për të fituar këtë pasuri, siç përcaktohet në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

21. Rezultatet e analizës financiare

21.1 Nga analiza financiare për periudhën 2003–2016, rezulton se në disa vite – gjatë të cilave janë kryer investime ose shpenzime të konsiderueshme – të ardhurat e ligjshme të realizuara nga subjekti i rivlerësimit nuk kanë qenë të mjaftueshme për të përballuar blerjet e pasurive të paluajtshme, për të realizuar njëkohësisht kursimet – gjendjen e likuiditeteve në bankë dhe *cash-in* në shtëpi – si dhe për të kryer shpenzimet jetike dhe ato të deklaruara nga vetë subjekti në kontratat e shitblerjes dhe në deklaratat noteriale, siç është shpjeguar në paragrafët dhe kapitujt e mësipërm. Konkretisht, Komisioni konstatoi se totali i bilanceve negative të pesë viteve, respektivisht: 2011 (-4.123.421 lekë); 2012 (-103.233 lekë); 2013 (-3.417.236 lekë) dhe 2015 (-1.800.64 lekë) del në shumën totale prej 7.823.954 lekësh.

- i) Komisioni ka argumentuar se përmbajtja e kontratave të shitblerjeve të dy apartamenteve të sipërpërmendura, si dhe deklaratimet noteriale të bëra nga subjekti, së bashku me palët e tjera

kontraktuese, dëshmojnë një tjetër panoramë të shpenzimeve të kryera, dhe pikërisht në respekt dhe nëpërmjet përlogaritjeve të të dhënave të këtyre dokumenteve zyrtare – të pakundërshtueshme deri në provën e kundërt – është arritur në rezultatet e analizës financiare si më lart.

- ii) Dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit është analizuar dhe vlerësuar se nuk ka pasur as përmbajtje dhe as forcë provuese të mjaftueshme për të ndryshuar kahun e rezultateve të pasqyruara në tabelat e mësipërme. Për rrjedhojë, në saje të rezultateve financiare të pasqyruara më lart, konstatohet një mungesë e aftësive paguese, të ardhura nga burime financiare të ligjshme – specifikisht në vitet 2011, 2012, 2013 dhe 2015 – të mjaftueshme për të përballuar të gjitha shpenzimet e kryera nga familja e subjektit të rivlerësimit në periudhat respektive, si dhe për të realizuar kursimet e deklaruara.

B. Në lidhje me pretendimet për shkelje procedurale

Pretendimet për procedurat e ushtruara nga ILDKPKI-ja, trupi gjykues i Kolegjit i çmon si të pabazuara në ligj dhe në prova, për sa më poshtë.

- i) Nga shkresa nr. {***} prot., datë 17.11.2017, e ILDKPKI-së, me lëndë “Dërgim i aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Rovena Gashi, me funksion prokuror, Drejtor i Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë pranë Prokurorisë së Përgjithshme”, vërehet se në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se për subjektin e rivlerësimit, znj. Rovena Gashi: a) deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin; b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; c) nuk është kryer fshehje e pasurisë; ç) është kryer deklarim i rremë; d) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit. Në këto kushte, ushtrimi i kompetencave nga ILDKPKI-ja është në përputhje me autorizimin ligjor sipas nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
- ii) Në lidhje me pretendimin për të drejtën t’u njohur, për të dhënë shpjegime dhe për të paraqitur prova në lidhje me aktin e ILDKPKI-së, neni 87, pikat 1 dhe 2 të K.Pr.Administrative përcaktojnë se përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik “[...] njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t’u dëgjuar, njoftim i cili përmban këto të dhëna: a) organin publik që zhvillon procedurën dhe nëpunësin publik përgjegjës; b) palët e përfshira; c) informacion për të drejtën e inspektimit të dosjeve dhe zyrës dhe vendin ku kjo mund të ushtrohet; ç) provat e administruara, rezultatet e hetimit, si dhe rezultatet e pritshme të procedurës administrative dhe motivimin përkatës; d) informacionin për të drejtën e palës për t’u dëgjuar dhe mënyrën dhe afatin e ushtrimit të kësaj së drejte; dh) datën e fillimit të procedurës dhe afatin kohor, brenda të cilit do të merret dhe njoftohet vendimi, në qoftë se një afat i tillë është i zbatueshëm”. Vërehet se Komisioni e ka përmbushur këtë detyrim sipas afatit ligjor, ndërkohë që nuk i është mohuar e drejta subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me dosjen, për t’u njohur me dokumentet e dosjes, si dhe për të marrë kopje të tyre, në përputhje me nenin 45 të Kodit të Procedurës Administrative.
- iii) Konfirmohet, nga deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 2.11.2013 (heqja dorë nga pronësia e apartamentit dhe dhurimi vajzës) dhe shkresa nr. {***} prot., datë 11.01.2018, e {***} (pagesa e shkollimit për K. dhe O.G.), se z. N.G. është person tjetër i

lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe mbartës i detyrimit për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, bazuar në nenin 1, pika 14, sipas së cilës “persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi, si dhe bazuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

21.2 Pretendimet për ushtrimin e funksionit nga Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, trupi gjykues i Kolegjit i çmon si të pabazuara në ligj dhe në prova. Bazuar në nenin 13 të K.Pr.Administrative, në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie. Pavarësisht mënyrës së zgjedhjes së organit publik, me votim unanim të organit kolegjal apo me shumicë votash, akti i prodhuar nga organi kolegjal shpreh vullnetin në tërësi të këtij të fundit dhe, nga ana tjetër, nuk vërtetohen pengesat ligjore të parashikuara nga neni 30 i K.Pr.Administrative për Inspektorin e Përgjithshëm.

21.3 Pretendimet se nuk mund të ndërmerret asnjë procedurë tjetër administrative në referim të urdhrit nr. {***}, datë 29.12.2017, të Prokurores së Përgjithshme, trupi gjykues i Kolegjit i çmon si të pabazuara në ligj dhe në prova dhe jashtë objektit të shqyrtimit. Në juridiksionin e rivlerësimit nuk përfshihet kontrolli i akteve të sistemit të zakonshëm të llogaridhënies, e cila nga ana tjetër është një tjetër procedurë që i nënshtrohet ligjit që rregullon fushën e përkatësisë.

21.4 Pretendimin për pavlefshmërinë absolute të akteve për shkak të komisioneres së përjashtuar, trupi gjykues i Kolegjit e çmon si të pabazuar në ligj dhe në prova. Bazuar në nenin 27, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, anëtari i institucioneve të rivlerësimit deklaroi dhe shmang çdo situatë konflikti interesi dhe, në rast se anëtari i institucioneve të rivlerësimit nuk mund të shqyrtojë një çështje që i është caktuar për shkaqet e përmendura në nenin 30 të K.Pr.Administrative ose të ligjit mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike, ai njofton me shkrim menjëherë trupin gjykues. Fakti i zëvendësimit të relatores, përjashtoi njëkohësisht edhe ndikimin e kësaj të fundit në zhvillimin e mëtejshëm të procesit, sikurse edhe mundësinë e të qenit përcaktuese në vendimmarrjen në fund të procedurës. Nga ana tjetër, trupi gjykues, sipas përbërjes me anëtarin e zëvendësuar, përmbush kushtin e garantimit të paanësisë në mungesë të vërtetimit të së kundërtës.

21.5 Pretendimin për përjashtimin nga lista e përparësisë dhe nga lista e subjekteve prioritare, trupi gjykues i Kolegjit e çmon si të pabazuar, në ligj dhe në prova. Kompetenca e shqyrtimit të çështjeve që i përkasin juridiksionit të rivlerësimit, përcaktohet nga fakti dhe ligji i zbatueshëm në momentin e fillimit të procesit dhe nuk ndikohet nga ndryshimet e mëvonshme të këtyre të fundit. Sipas përcaktimeve të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, në nenin 5, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, kompetentë për kryerjen e procesit të vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit janë Komisioni, Kolegji i Apelit, komisionerët publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë.

21.6 Pretendimin për pamundësimin për t’u dëgjuar dhe pjesëmarrje reale/efektive në seancë dëgjimore, trupi gjykues i Kolegjit e çmon si të pabazuar në ligj dhe në prova. Në bazë të nenit

35, pika 1 e K.Pr.Administrative, pala mund t'i kryejë të gjitha veprimet procedurale personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit. Vërehet se subjekti i rivlerësimit ka përzgjedhur t'i kryejë të gjitha veprimet procedurale personalisht, në çdo fazë të shqyrtimit deri në përmbylljen e tij. Nuk konstatohet pamundësia për të zgjedhur një mbrojtës, përkundrazi ka përzgjedhur të dëgjohet pa përfaqësues në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni, në distancë me bazë dokumentesh, me anë të deklaratës përmbyllëse të dërguar elektronikisht dhe njëkohësisht në formë shkresore, si një formë e përshtatshme e njohur nga neni 88, pika 1 e K.Pr.Administrative.

21.7 Pretendimin për pengimin e aksesit në gjykatë, pasi ka shtyrë shpalljen dhe ka vonuar të drejtën e njoftimit të vendimit dhe, për pasojë, të drejtën e ankimit, trupi gjykues i Kolegjit e çmon si të pabazuar në ligj dhe në prova. Bazuar në nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në K.Pr.Administrative ose në ligjin për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, ndërkohë që neni 42, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 përcakton se në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykata shtyn shpalljen e vendimit deri në 5 (pesë) ditë, përcaktime që e lejojnë shpalljen e vendimit në ditë të ndryshme nga data e përfundimit të shqyrtimit të çështjes. Nga ana tjetër, e drejta e ankimit kundër vendimit të Komisionit fillon nga data e njoftimit me shkrim të vendimit të arsyetuar, datë nga e cila fillon llogaritja e afatit të ankimit, dhe shtyrja e shpalljes apo e njoftimit nuk përbëjnë shkaqe për cenimin e vendimit të dhënë.

21.8 Pretendimin për caktimin e përfaqësuesit kryesisht për shkak të paaftësisë për punë, trupi gjykues i Kolegjit e çmon si të pabazuar, në ligj dhe në prova, për sa më poshtë:

- i) Në bazë të nenit 36, pikat 2 dhe 3 të K.Pr.Administrative, organi publik që kryen procedurën administrative, mund të caktojë një përfaqësues të përkohshëm për kryerjen e një veprimi të caktuar procedural, ose deri në caktimin apo zëvendësimin e përfaqësuesit ligjor edhe kur: “[...] c) pala është në pamundësi objektive për të ndjekur interesat e vet dhe nuk ka zgjedhur një përfaqësues [...]”.
- ii) Vërehet se ankuesja në deklaratën përmbyllëse shprehet se “subjekti i rivlerësimit Rovena Gashi do të paraqitet përpara asaj gjykate të nderuar, që ka dhënë garancitë e nevojshme për dëgjimin realisht të saj, para se të marrë një vendim mbi të drejta kaq të rëndësishme dhe themelore për subjektin e rivlerësimit”, dhe gjithashtu “duke qenë se pa një proces të drejtë, nuk mund të ketë një vendimmarrje të drejtë ndaj saj, subjekti i rivlerësimit Rovena Gashi kërkon rikonfirmimin e saj në detyrë si prokurore në Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë”.
- iii) Nuk vërehet, në këto kushte, pamundësia objektive e subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, për të ndjekur interesat e veta, për sa kohë që ka qenë e aftë të kryejë rregullisht veprimin procedural në një nga format e pranuar nga ligji procedural, pavarësisht pretendimit të paaftësisë së përkohshme për të punuar. Për më tepër, nuk vërehet as edhe dijenia e Komisionit, në lidhje me paaftësinë e përkohshme të subjektit të rivlerësimit.

21.9 Pretendimin për mosplotësimin e kushteve për anëtar të institucioneve të rivlerësimit të njërit prej komisionerëve, trupi gjykues i Kolegjit e çmon si të pabazuar në ligj dhe në prova. Është kompetencë e Kuvendit të Shqipërisë, i cili me anë të vendimit nr. 82/2017 “Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016

“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka miratuar listën në bllok e kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, nga ku vërehet nr. 11, Lulzim Hamitaj, komisioner në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Vendimi nr. 82/2017 i Kuvendit të Shqipërisë, i miratuar në datën 17.06.2017, ka hyrë në fuqi menjëherë, është i vlefshëm dhe nuk ka pësuar ndryshime të mëtejshme për këtë komisioner, dhe cilësia e dhënë nga Kuvendi nuk mund të kundërshtohet nëpërmjet shkakut ankimor.

21.10 Pretendimin në lidhje me funksionet e ushtruara nga vëzhguesja ndërkombëtare, trupi gjykues i Kolegjit e çmon si të pabazuar në ligj dhe në prova. Objekti i gjykimit para Kolegjit të Apelit është shqyrtimi i vendimit të Komisionit, në drejtim të respektimit të ligjit procedural dhe zbatimit të drejtë të ligjit material për faktet juridike të provuara dhe të gjitha shkaqet e ngritura për pavarësinë e vëzhgueses ndërkombëtare janë trajtuar përkatësisht dhe gjejnë përgjigje në këtë vendim. Nga ana tjetër, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit ushtron funksionet që burojnë nga neni B i Aneksit të Kushtetutës, dhe këto funksione nuk janë objekt kontrolli nga ana e Kolegjit.

21.11 Pretendimet në lidhje mosidentifikimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, e identitetit dhe të dispozitave ligjore, trupi gjykues i Kolegjit i çmon si të pabazuara në ligj dhe në prova, për sa më poshtë.

- i) Bazuar në nenin 57, pikat 2 dhe 3, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016, vendimi përmban hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe urdhëruese, ndërsa hyrja e vendimit përmban, ndër të tjera, emrin dhe identitetin e subjektit të rivlerësimit. Ligji është mjaftuar me identifikimin e subjektit të rivlerësimit, që në fakt është shkak ligjor për të cilin i nënshtrohet këtij procesi dhe vendimmarrjes sipas rastit. Rivlerësimi me përparësi ka të bëjë thjesht dhe vetëm me shortimin e çështjeve për kompetencë të trupave përkatëse gjyquese, pasi procesi i rivlerësimit ka filluar qysh me dorëzimin e deklaratave përkatëse për kontrollin dhe vlerësimin e secilit kriter. Vërehet se në pjesën hyrëse të vendimit, Komisioni shprehimisht e identifikon subjektin e rivlerësimit si në vijim: “Znj. Rovena N. Gashi, me detyrë prokurore pranë Prokurorisë së Përgjithshme”.
- ii) Bazuar në nenin 57, pika 4, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016, pjesa përshkruese-arsyetuese përmban, ndër të tjera, dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi. Vërehet se Komisioni ka konkluduar se lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratime të pamjaftueshme dhe nuk ka dhënë shpjegime bindëse, referuar pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe se ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016. Gjithashtu, trupi gjykues e ka bazuar pjesën urdhëruese në nenet 179/b, D, pikat 1, 3, 5 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
- iii) Subjekti i rivlerësimit nuk i nënshtrohet procesit për shkak të shkakut ligjor të përparësisë, por për shkak se gëzon statusin prokuror dhe, për këtë arsye, pjesa hyrëse e vendimit përmbush kërkesat ligjore në aspektin formal. Gjithashtu, përkundër sa pretendon ankuesja, në pjesën arsyetuese përmban rregullisht dispozitat ligjore në të cilat është mbështetur vendimi.

21.12 Pretendimin në lidhje me mospranimin e provave, trupi gjykues i Kolegjit e çmon si të pabazuar në ligj dhe në prova. Bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, të drejtat e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit rregullohen sipas përcaktimeve të neneve 35-40 dhe të neneve 45-47 të K.Pr.Administrative. Neni 47 i K.Pr.Administrative përcakton se të gjitha palët, në çdo fazë të procedurës, kanë të drejtë të paraqesin mendime dhe shpjegime për fakte, rrethana apo çështje ligjore, si dhe të depozitojnë prova ose të paraqesin propozime për zgjidhjen e çështjes. Në këto kushte, ky pretendim i ankueses është i pabazuar, pasi subjekteve të rivlerësimit u njihet shprehimisht e drejta për të paraqitur prova dhe shpjegime, jo vetëm pas mbylljes së hetimit administrativ, por në çdo fazë të procedurës.

21.13 Pretendimin në lidhje antikushtetutshmërinë e procesit, për shkak të mosshqyrtimit edhe të dy kriterëve të tjera, trupi gjykues i Kolegjit e çmon si të pabazuar në ligj dhe në prova. Neni 4 i ligjit nr. 84/2016, parashikon objektin dhe parimet e procesit të rivlerësimit, parimet e përgjithshme të këtij procesi, sikurse edhe rastet përjashtimore, në funksion të shqyrtimit brenda një afati sa më të shpejtë të mundshëm. Pikat 2 dhe 3 në mënyrë vijuese përcaktojnë se vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve ose në vlerësimin tërësor të procedurave, dhe se kur çështja është gati për t'u shqyrtuar, institucionet e rivlerësimit vendosin brenda një afati sa më të shpejtë të mundshëm. Ligjvënësi ka çmuar se është në interesin publik shqyrtimi i çështjes brenda një afati sa më të shpejtë të mundshëm dhe, për këtë arsye, ka ligjëruar përfundimin bazuar vetëm në një kriter, kur rezultatet e hetimit për kriterin përkatës janë të mjaftueshme për të mbështetur vendimmarrjen.

21.14 Pretendimin në lidhje me mungesën e bashkëpunimit dhe të drejtën për të paraqitur kërkesa procedurale, trupi gjykues i Kolegjit e çmon si të pabazuar në ligj dhe në prova. Niveli bashkëpunimit të subjekteve të rivlerësimit është një prej shkaqeve që ndikojnë në nivelin e besueshmërisë së subjekteve që rivlerësohen, në mbështetje të vendimmarrjes përfundimtare. Bazuar në nenin 48 subjekti i rivlerësimit bashkëpunon me Komisionin dhe Kolegjin e Apelit, të cilët, në marrjen e vendimit, mbajnë parasysh gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit, ndërkohë që kërkesat procedurale gjithmonë duhet të jenë në funksion të objektit të shqyrtimit. Subjekti i rivlerësimit nuk rezultoi të ketë qenë bashkëpunues as edhe në procedurën gjyqësore para Kolegjit.

21.15 Pretendimin në lidhje me mosparaqitjen e provave të reja dhe mosushtrimin e barrës së provës, trupi gjykues i Kolegjit e çmon si të pabazuar në ligj dhe në prova. Përkundër sa pretendon subjekti i rivlerësimit, se i është refuzuar marrja e provave të reja, vërehet se subjekti i rivlerësimit me kërkesën e datës 07.07.2018, të refuzuar nga Komisioni, rezultoi se ka kërkuar nga ky i fundit kryerjen e veprimeve të tjera procedurale, duke kërkuar marrjen e provave shkresore nga institucione shtetërore dhe subjekte të tjera private, si dhe marrjen e dëshmimeve për të vërtetuar marrëdhënie juridike për të cilat ligji kërkon shkresë (marrëdhënia juridike e huas, faktin e administrimit të pallatit, faktin e të qenit banor i pallatit), në një kohë që Komisioni kishte vlerësuar se provat e grumbulluara arrinin nivelin e provueshmërisë për vendimin përfundimtar për kriterin e pasurisë. Kërkesa e subjektit të rivlerësimit ishte jashtë konceptit të barrës së provës, ndërkohë që ndodhej para faktit e prezumimit prej Komisionit se provat e grumbulluara kishin arritur nivelin e provueshmërisë.

21.16 Pretendimin në lidhje me z. N.G., cilësimin si person tjetër i lidhur dhe ligjshmërinë e burimeve për pasuritë e dhuruara, trupi gjykues i Kolegjit e çmon si të pabazuar në ligj dhe në prova. K.Pr.Civile ka vendosur kufij për lejimin e provave me dëshmitarë. Neni 231 i K.Pr.Civile

përcakton se prova me dëshmitarë lejohet në të gjitha rastet, përveç kur ligji për vlefshmërinë ose për provimin e një veprimi juridik kërkon shkresë. Nga deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.11.2013, e kryer nga shoqëria ndërtuese {***} ShPK, z. T.M., z. N.G., znj. Rovena Gashi dhe z. D.G., shoqëria {***} ShPK, investitori z. T.M. kanë lidhur kontratën e porosisë së datës 28.10.2004 dhe z. N.G., pasi ka rregulluar të gjitha marrëdhëniet financiare me investitorin, ka vendosur të heqë dorë nga pronësia e apartamentit dhe t'ia dhurojë atë vajzës së tij, znj. Rovena Gashi, dhe bashkëshortit të saj, z. D.G.. Nga shkresa nr. {***} prot., datë 11.01.2018, e {***} rezulton se më datë 24.08.2017, z. N.G. ka kryer pagesën e shkollimit për K. dhe O.G. në shumën 4000 euro, dhe në datën 04.01.2018 z. N.G. ka kryer pagesën e shkollimit për . dhe O.G. në shumën 3000 euro. Bazuar në këto fakte dhe në nenin 1, pika 14 dhe në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, konfirmohet se z. N.G. është person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe mbartës i detyrimit për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive. Shprehimisht, neni 1, pika 14 përcakton se “persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi, ndërsa neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 përcakton: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”. Babai i subjektit të rivlerësimit plotëson kushtet për t'u cilësuar person tjetër i lidhur, për shkak të kontratës se porosisë dhe pagesës së shkollimit të fëmijëve, dhe trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit.

21.17 Pretendimin se për efekte të shkarkimit kërkohet pamjaftueshmëri për dy kritere njëkohësisht, trupi gjykues i Kolegjit e çmon si të pabazuar në ligj dhe në prova, për sa më poshtë.

- i) Masa e shkarkimit nga detyra është interpretuar në mënyrë autentike nga ligjvënësi. Shprehimisht, neni 61 i ligjit nr. 84/2016 përcakton se shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: “i) kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të; ii) kur rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, sepse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, që bën të pamundur vazhdimin e detyrës; iii) kur rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji; iv) kur rezulton si i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale; v) në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.”
- ii) Interpretimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me nenin 61, pika 3, është një interpretim për zbatim të gabuar të kësaj dispozite, duke pretenduar se përmbajtja e kësaj dispozite e lidh shkarkimin nga detyra të subjektit me të paktën dy kritere njëkohësisht, në një kohë që neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ka parashikuar dhe autorizuar qartësisht Komisionin dhe Kolegjin e Posaçëm të Apelit që ata mund të marrin vendim të bazuar në një ose disa prej kritereve. Pra, vendimi i Komisionit për këtë shkak të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit është i pacenueshëm. Investimi dhe disponimi i Komisionit në definicion vetëm për një

element, atë të pasurisë, është i ligjshëm dhe në respektim të qartë të dispozitave të mësipërme të ligjit të posaçëm nr. 84/2016.

C. Në lidhje me aktet që subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të merren si prova

22. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi i analizoi në tërësi aktet shoqëruese me ankimin dhe parashtresat, aspektet procedurale, formale dhe përmbajtësore të këtyre akteve shoqëruese, vlerëson sa më poshtë.

- i) Ankuesja nuk ka arritur të provojë se, pa fajin e saj, aktet e reja që subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të merren si prova shoqëruese të ankimit, nuk janë paraqitur rregullisht dhe sipas afateve procedurale, sipas përcaktimeve të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012.
- ii) Me aktet e paraqitura dhe të vërtetuara para noterit, sipas veprimeve noteriale në vijim, synohet të provohen fakte¹⁴ që kanë ndodhur para dhënies së vendimit nga Komisioni, por se, nga ana tjetër, nuk vërtetohet në asnjë rast se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur faj për mosparaqitjen e akteve të vërtetuara sipas këtyre veprimeve noteriale, në momentin procedural dhe sipas urdhërimit ligjor. Sikurse konfirmohet nga vërtetimet e njësisë me origjinalin nr. {***} rep., datë 22.06.2018, nr. {***} rep., datë 26.09.2018, nr. {***} rep., datë 27.09.2018, nr. {***} rep., datë 26.09.2018, subjekti i rivlerësimit ka vërtetuar njësinë me origjinalin e dokumenteve që datojnë më herët se veprimi noterial.
- iii) Trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit është vënë në lëvizje pas rezultateve të hetimit paraprak dhe kalimit të barrës së provës¹⁵, jo duke paraqitur prova të reja, por duke kërkuar nga Komisioni që të mblidhte prova të tjera në vijim të postimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit në drejtim të institucioneve të ndryshme, dhe për më tepër që në seancën dëgjimore ka kërkuar rikonfirmimin në detyrë¹⁶. Përkundër sa pretendon subjekti i rivlerësimit, se i është refuzuar marrja e provave të reja, vërehet se subjekti i rivlerësimit me kërkesën e datës 7.7.2018, të refuzuar nga Komisioni, ka kërkuar kryerjen e veprimeve të tjera procedurale, duke kërkuar marrjen e provave shkresore nga institucione shtetërore dhe subjekte të tjera private, si dhe marrjen e dëshmimeve për të vërtetuar marrëdhënien juridike që ligji kërkon shkresë (marrëdhënia juridike e huas, faktin e administrimit të pallatit, faktin e të qenit banor i pallatit) në një kohë që Komisioni kishte vlerësuar se provat e grumbulluara arrinin nivelin e provueshmërisë për vendim përfundimtar për kriterin e pasurisë. Ndryshe nga përcaktimi ligjor për barrën e provës, subjekti i rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, kërkoi nga Komisioni që t'i merrte. Ajo duhet t'i kishte kërkuar këto prova nga institucionet dhe t'i

¹⁴ Përveç akteve: "Shkresës kthim përgjigjeje nr. {***} prot., datë 18.07.2018, e Drejtorisë së ALUIZNIT Durrës; deklaratë noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 11.09.2018 e z. N.G.; deklaratë noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 11.09.2018 e z. T. M.; deklaratë noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 07.09.2018 e znj. Sh. V.; deklaratë noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 07.09.2018 e znj. M. L.; deklaratë noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 11.09.2018 e z. A. Xh.; pasqyrë e nxjerrjes së llogarisë së klientit - shoqëria "{***}" ShPK, datë 27.07.2018; të dhëna lidhur me periudhën e ushtrimit të aktivitetit tregtar nga ana e tatimpaguesit, z. N.G., për periudhën 01.07.1998 - 31.12.2005, sipas vërtetimit nr. {***} prot., datë 28.08.2018 i DRSSH Durrës, por që edhe faktet në përmbajtje që synohet të provohen me këto akte, janë më të hershme se vendimmarrja e Komisionit.

¹⁵ Subjektit të rivlerësimit i ka kaluar barra e provës në datën 26.06.2016, ndërkohë që është vënë në lëvizje për të kërkuar prova nga institucionet e përmendura në datën 07.07.2018, duke postuar disa shkresa në drejtim të institucioneve të ndryshme.

¹⁶ Nga "Deklarata përmbyllëse nr. {***} prot., datë 20.07.2018, rezulton të jetë shprehur: "Për të gjitha sa më lart, duke qenë se pa një proces të drejtë nuk mund të ketë kursesi një vendimmarrje të drejtë ndaj saj, subjekti i rivlerësimit kërkon rikonfirmimin e saj në detyrë si prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë."

paraqiste në Komision brenda afateve të caktuara nga trupi gjykues i Komisionit i caktuar për kryerjen e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

- iv) Nga analizimi dhe krahasimi në përmbajtje të akteve, rezultojnë se janë paraqitur për t'u marrë si prova të reja, akte që rezultojnë të administruara në dosjen¹⁷ e përcjellë nga Komisioni dhe, për më tepër, që një pjesë e konsiderueshme e këtyre akteve rezultojnë të cituara në mënyrë të drejtpërdrejtë¹⁸ edhe në tekstin e vendimit nr. 48, datë 25.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, të shpallur publikisht. Duke vijuar me përmbajtjen e akteve, ndërkohë që vendimi i ankimuar nga subjekti i rivlerësimit është i bazuar në 4 (katër) konstatime¹⁹, me aktet e paraqitura si me synimin për t'u marrë si prova të reja, kryesisht synojnë të sjellin ndryshime në aftësinë paguese të babait të subjektit të rivlerësimit, fakt që nuk ndikon në vendimmarrjen e Komisionit.
- v) Aktet e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, vijnë nga burime të njohura, janë të besueshme dhe në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera, mjaftueshëm për të mbështetur shqyrtimin e vendimit të Komisionit nga Kolegji i Apelit, në drejtim të deklarimit të pasurive dhe burimeve respektive të krijimit. Aktet që

¹⁷ Shih aktet: "Praktika mbi aplikimin, regjistrimin e çështjes dhe fillimin e shqyrtimit të saj nga GjEDNj; certifikatë për vërtetimin e pronësisë së pasurisë nr. {***}, zk {***}, në emër të shoqërisë {***}; kartela e pasurisë së paluajtshme; kontratë shitjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 11.07.2013, lidhur mes palëve në cilësinë e blerësit shoqëria {***} ShPK, investitori T. M. dhe në cilësinë e blerësit M. H. (praktikë e ngjashme me rastin e subjektit të rivlerësimit, që janë ndjekur nga ana e shoqërisë së ndërtimit {***} ShPK, lidhur me porositjen dhe shitjen e apartamenteve në këtë pallat); kontratë shitjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 08.08.2014, lidhur mes palëve në cilësinë e blerësit R. V. (praktikë e ngjashme me rastin e subjektit të rivlerësimit, që janë ndjekur nga ana e shoqërisë së ndërtimit {***} ShPK lidhur me porositjen dhe shitjen e apartamenteve në këtë pallat); shkresa kthim përgjigje {***} prot., datë 10.01.2018, nëpërmjet së cilës synohej të provohej momenti kohor kur subjekti ka filluar të banojë, duke paguar tarifat përkatëse të furnizimit me ujë, duke filluar nga periudha janar 2006, ndërsa data 31.10.2004 që synohej të provohej se lidhej me momentin e lidhjes së kontratës nga ana e shoqërisë së ndërtimit; vërtetim hipotekor nr. {***}, datë 07.12.2011; vërtetim nga Seksioni i Kadastrës, datë 04.08.1993, mbi pronat e regjistruara në emër të R. G.; vendim nr. {***}, datë 16.10.1998, i KKKP ish-Pronarëve së bashku me planimetrinë përkatëse; vërtetim sipas të cilit synohej të vërtetohej gjendja e pronave të regjistruara në regjistrin hipotekor nr. {***}, datë 21.10.1998, në emër të R. G., S.H., H.G. dhe N.G.; vërtetim pronësie i datës 19.09.1997; kontratë qiraje nr. {***} rep., {***} kol., datë 14.04.2016; kontratë qiraje nr. {***} rep., {***} kol., datë 03.02.2017; kontratë qiraje nr. {***} rep., {***} kol., datë 31.01.2018".

¹⁸ Shih aktet: "Kontratë porosie, datë 28.10.2014, me nr. referencë të ZVRPP Tiranë {***}; akt noterial nr. {***} rep., datë 02.11.2013; deklaratë noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 2.11.2013; kontratë shitjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 12.11.2013 - deklaratë datë 06.10.2011 e ortakut të shoqërisë "{***}" ShPK, e cila është konfirmuar me shkresën nr. {***} prot., datë 19.01.2017; kërkesë për transferim fondesh, datë 21.12.2011, nga llogaria e klientit D.G. në llogarinë e përfutuesit shoqëria "{***}" ShPK - kontratë shitblerjeje objekti nr. {***} rep., {***} kol., datë 13.02.1998; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 7.8.1997; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 11.11.1997; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 13.10.1998 - kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 08.06.1999; kontratë shitblerjeje me kusht nr. {***} rep., {***} kol., datë 24.07.1999; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 19.08.1999; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 02.09.1999; kontratë shitblerjeje me kusht nr. {***} rep., {***} kol., datë 15.11.1999; kontratë shitjeje apartamenti nr. {***} rep., {***} kol., datë 01.02.2000, shoqëruar me vërtetimin hipotekor; kontratë shitblerjeje apartamenti nr. {***} rep., {***} kol., datë 12.06.2000; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 17.08.2000; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 2.10.2000; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 04.10.2000 - kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 08.10.2000 - kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 06.04.2001; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 02.05.2001; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 02.05.2001; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 22.04.2004, shoqëruar me vërtetimin hipotekor; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 22.04.2004, shoqëruar me vërtetimin hipotekor, si dhe me hartën treguese të regjistrimit; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 22.04.2004, shoqëruar me vërtetimin hipotekor; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 19.07.2004, shoqëruar me vërtetimin hipotekor të regjistrimit; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 19.07.2004, shoqëruar me vërtetimin hipotekor, si dhe hartën treguese të regjistrimit; deklaratë noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 24.06.2004; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 29.10.2005; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 29.10.2005; kontratë qiraje nr. {***} rep., {***} kol., datë 5.5.2011; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 02.12.2011, shoqëruar me vërtetimin hipotekor; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 05.04.2012, shoqëruar me vërtetimin hipotekor, si dhe planimetrinë përkatëse; kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., {***} kol., datë 09.01.2013; leja e legalizimit me numër serial {***}, në emër të N.G., bashkëlidhur planimetria e ndërtimit; kontratë qiraje nr. {***} rep., {***} kol., datë 14.05.2014; kontratë qiraje nr. {***} rep., {***} kol., datë 19.01.2016, shoqëruar me certifikatën e vërtetimit të pronësisë, së bashku me planimetrinë përkatëse; kontratë qiraje nr. {***} rep., {***} kol., datë 22.01.2016".

¹⁹ Shih: "1) apartament banimi në zonën e {***}, me sip. 105 m², lagjja nr. {***}, {***}, Durrës; 2) apartament banimi me sip. 121 m², në ish-rr. "{***}", Tiranë, aktualisht rr. "{***}"; 3) rezultatet e analizës financiare; 4) konstatime mbi burimet financiare të ligjshme të babait të subjektit të rivlerësimit, z. N.G..

kërkohen të merren si prova të reja, përveç përsëritjeve dhe pa provuar mungesën e fajit të subjektit të rivlerësimit për ushtrimin në kohë të kësaj të drejte ligjore, fakti që kërkohet të provohet synon të sjellë risi për babain e saj, çka nuk ndikon thelbësisht në marrjen e vendimit.

23. **Për sa më sipër**, lidhur me aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, bashkëlidhur ankimit, që kërkohet të merren si prova, të depozituara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për vendimin nr. 48, datë 25.07.2018, trupi gjykues i Kolegjit vendosi që, bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të refuzojë marrjen e këtyre provave. Gjithashtu, trupi gjykues i Kolegjit vendosi refuzimin e këtyre provave, sepse: i) marrja e provave duket se është e panevojshme, sipas përcaktimit të nenit 49, pika 6, germa “a” e ligjit nr. 84/2016²⁰; ii) bëhet me

²⁰ Shih aktet: “Dëftesa postare mbi komunikimin në datën 13.09.2018 të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 48, datë 25.07.2018; praktika mbi aplikimin, regjistrimin e çështjes dhe fillimin e shqyrtimit të saj nga GjEDNj-ja; kërkesat procedurale të subjektit të rivlerësimit; lista e subjekteve të përparësisë në rivlerësim; aktet mbi fillimin e hetimit për komisionerin Lulzim Hamitaj; kontratë porositje, datë 28.10.2004; akt noterial nr. {***} rep., datë 02.11.2013; deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.11.2013; kontratë shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.11.2013; certifikatë për vërtetimin e pronësisë së pasurisë nr. {***}, zk {***}, në emër të shoqërisë {***} ShPK; kartela e pasurisë së paluajtshme; certifikatë për vërtetimin e pronësisë së pasurisë nr. {***}, zk {***}, në emër të znj. Rovena Gashi dhe z. D.G.; kartela e pasurisë së paluajtshme; kontratë shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.07.2013; kontratë shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.08.2014; certifikatë familjare e subjektit të rivlerësimit, datë 29.04.2016; shkresë kthim përgjigjeje nr. {***} prot., datë 18.07.2018, e Drejtorisë së ALUIZNIT Durrës; kontratë nr. {***}, datë 24.11.2004, “Për furnizimin me energji elektrike, e lidhur me z. T. M.”; librezë e energjisë elektrike, lëshuar për abonentin, z. T.M.; shkresë kthim përgjigjeje nr. {***}, datë 12.01.2018; shkresë kthim përgjigjeje {***} prot., datë 10.01.2018; deklaratë noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 11.09.2018, e z. N.G.; deklaratë noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 11.09.2018, e z. T.M.; deklaratë e datës 06.10.2011 e ortakut të shoqërisë “{***}” ShPK; deklaratë e datës 06.10.2011 e ortakut të shoqërisë “{***}” ShPK, e cila është konfirmuar me shkresën nr. {***} prot., datë 25.10.2016; deklaratë, datë 06.10.2011, e ortakut të shoqërisë “{***}” ShPK, e cila është konfirmuar me shkresën nr. {***} prot., datë 19.01.2017; shkresa nr. extra prot., datë 01.08.2017, e shoqërisë “{***}” ShPK, dërguar ILDKPKI-së; kontratë themelimi e shoqërisë “{***}” ShPK, datë 03.01.2008; statuti i shoqërisë “{***}” ShPK, datë 20.05.2011; vendim i KRRT-së nr. {***}, datë 21.04.2006, “Për miratimin e lejes së sheshit të ndërtimit”; leja e ndërtimit nr. {***}, datë 10.01.2018; leja e shfrytëzimit për godinën 7 kate + 2 kate garazh + papafingo; kontratë sipërmarrjeje ndërtimi nr. {***} rep., {***} kol., datë 16.01.2008; ekstrakti historik i shoqërisë “{***}” ShPK, me NIPT {***}; shkresë kthim përgjigjeje e shoqërisë “{***}” ShPK, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, e cila me shkresën nr. {***} prot., datë 26.6.2018, ka kërkuar të dhëna lidhur me pas. nr. {***}, zk {***}, vol. {***}, f. {***}, me vendndodhje në lagjen nr. {***}, {***}, Durrës, e deklaruar në bashkëpronësi nga subjekti i rivlerësimit, znj. Rovena Gashi; kërkesë për transferim fondesh, datë 21.12.2011, nga llogaria e klientit D.G. në llogarinë e përfuturit shoqëria “{***}” ShPK; pasqyrë e nxjerrjes së llogarisë së klientit shoqëria “{***}” ShPK që vërteton kalimin e shumës së disbursuar si kredi nga llogaria e D.G. në llogarinë e shoqërisë; pasqyrë e gjendjes së klientit D.G., nxjerrë nga dokumentacioni kontabël i shoqërisë “{***}” ShPK; libri i shitjeve, i deklaruar në muajin dhjetor, i shoqërisë “{***}” ShPK, shoqëruar me formularin e deklarimit dhe pagesës së TVSh-së; pasqyrat financiare të shoqërisë “{***}” ShPK; shkresë kthim përgjigjeje nr. {***} prot., datë 22.05.2018, e bankës “{***}”, lidhur me momentin e përcaktimit kohor të aplikimit për kredi nga ana e klientit D.G.; shkresa kthim përgjigjeje nr. {***} prot., datë 15.5.2018, e bankës “{***}”, lidhur me raportin e vlerësimit pikërisht të apartamentit nr. {***}, me nr. {***}, zk {***}, që ishte lënë si kolateral për garantimin e kredisë; kontrata e kredisë bankare dhe hipotekore nr. {***} rep., {***} kol., datë 19.12.2011; vërtetim hipotekor nr. {***}, datë 7.12.2011; vërtetim hipotekimi i pas. Nr. {***} zk {***} në favor të përfuturit, bankës “{***}”, së bashku me planimetrinë përkatëse; polica e sigurimit të pasurisë; shkresë kthim përgjigjeje e OSHEE-së nr. {***} prot., datë 12.10.2018; certifikatë familjare nr. {***}, datë 29.03.2018; certifikatë familjare nr. {***}, datë 27.3.2018; certifikatë familjare nr. {***}, datë 29.03.2018; certifikatë familjare nr. {***}, datë 29.03.2018; certifikatë familjare nr. {***}, datë 06.03.2018; certifikatë familjare nr. {***}, datë 10.04.2018; librezë pune e z. N.G.; shkresë kthim përgjigjeje nr. {***} prot., datë 11.07.2018, e Drejtorisë së Arkivit Qendror mbi vërtetimin e vjetërsisë në punë të z. N.G. dhe znj. E.G.; librezë pune e znj. E.G.(M.), shoqëruar me vendimin për caktim pensioni; të dhëna lidhur me periudhën e ushtrimit të aktivitetit tregtar nga ana e tatimpaguesit, z. N.G., nga viti 01.07.1998 - 31.12.2005; leje ndërtimi, datë 30.12.1992, në emër të znj. S.H.; kontratë shitjeje, datë 28.12.1992, me objekt “Shitje pronë shtetërore në favor të palës blerëse S.H.”, vendim nr. {***}, datë 9.8.1993, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; formular vetëdeklarimi për legalizimin e objektit shtëpi banimi + magazinë, me vendndodhje {***}/Durrës; shkresë përcjellëse nr. {***} prot., datë 16.07.2018, e Entit Kombëtar të Banesave, mbi bazën e së cilës i dërgohet subjektit të rivlerësimit praktika dokumentare mbi tabelat e kostos mesatare të ndërtimit për vitin 1995 të Entit Kombëtar të Banesave, që i referohen vendimit nr. 815, dt. 9.12.1996, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vlefave mesatare vjetore të apartamenteve tip në tregun e lirë dhe të vlefës të koeficientit K, si dhe tabelën e kostos mesatare të ndërtimit për vitet 1996-1997”; kontratë blerjeje, datë 02.10.1993, me palë shitëse Ndërmarrja Komunale Banesa dhe palë blerëse znj. S.H., z. N.G. dhe znj. E.G.; vërtetim nga Seksioni i Kadastrës, datë 04.08.1993, mbi pronat e regjistruara në emër të z. R.G.; vendim nr. {***}, datë 23.02.1995, i KKKP ish-Pronarëve së bashku me procesverbalin e piktimit të pronës në terren; vërtetim pronësie, datë 19.09.1997; vërtetim pronësie, datë 18.09.1997; vendim nr. {***}, datë 16.10.1998, i KKKP ish-Pronarëve së bashku me planimetrinë përkatëse; vërtetim sipas të cilit vërtetohet gjendja e pronave të regjistruara në regjistrin hipotekor nr. {***}, datë 21.10.1998, në emër të z. R.G., znj. S.H., z. H.G. dhe z. N.G.; vërtetim i Seksionit të Kadastrës, datë 02.07.1994; vendim nr. {***}, datë 19.05.1994, i KKKP ish-Pronarëve, bashkëlidhur me procesverbalin e piktimit në terren të pronës; vendim nr. {***}, datë 13.10.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, shoqëruar me planimetrinë, vendim nr. {***}, datë 27.06.1996, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, shoqëruar me planimetrinë; kontratë shitblerjeje

qëllim zvarritjen e gjykimit, sipas përcaktimit të nenit 49, pika 6 germa “ç” e ligjit nr. 84/2016²¹; dhe iii) pretendohet të provohen fakte në favor të subjektit të rivlerësimit, të cilat edhe po të konsiderohen të vërteta, nuk ndikojnë në marrjen e vendimit, sipas përcaktimit të nenit 49, pika 6, germa “d” e ligjit nr. 84/2016²². Lidhur me aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, bashkëlidhur parashtrimeve datë 13.03.2019 në Kolegj, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të refuzojë pranimin e tyre, sipas nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012.

objekti nr. [***] rep., [***] kol., datë 13.02.1998; vërtetim pronësie, datë 19.09.1997; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 07.08.1997; kontratë shitje trualli nr. [***] rep., [***] kol., datë 19.09.1997; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 11.11.1997; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 14.3.1998; kontratë shitje trualli nr. [***] rep., [***] kol., datë 19 maj 1998; vërtetim pronësie, datë 19.09.1997, së bashku me planimetrinë; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 13.10.1998; akt premtim shitjeje i një banese dhe sip. trualli, datë 19.11.1998; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 15.04.1999; kontratë shitjeje trualli nr. [***] rep., [***] kol., datë 26.04.1999; kontratë pajtimi vullnetar nr. [***] rep., [***] kol., datë 03.09.1997; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 11.05.1999; kontratë pajtimi vullnetar nr. [***] rep., [***] kol., datë 03.09.1997; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 8.6.1999; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 11.06.1999; kontratë shitblerjeje me kusht nr. [***] rep., [***] kol., datë 24.07.1999; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 19.08.1999; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 02.09.1999; kontratë shitblerjeje me kusht nr. [***] rep., [***] kol., datë 15.11.1999; kontratë shitjeje apartamenti nr. [***] rep., [***] kol., datë 01.02.2000, shoqëruar me vërtetimin hipotekor; kontratë shitblerjeje apartamenti nr. [***] rep., [***] kol., datë 12.06.2000; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 17.8.2000; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 02.10.2000; shkresë kthim përgjigjeje nr. [***] prot., datë 18.07.2018, e Drejtorisë ALUIZNI Durrës, formular vetëdeklarimi, deklaratë noteriale, kontratë shitblerjeje, leja e legalizimit; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 04.10.2000; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 08.10.2000; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 06.04.2001; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 02.05.2001; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 02.05.2001; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 18.08.2003; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 22.04.2004, shoqëruar me vërtetimin hipotekor; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 22.04.2004, shoqëruar me vërtetimin hipotekor, si dhe me hartën treguese të regjistrimit; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 22.04.2004, shoqëruar me vërtetimin hipotekor; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 19.07.2004, shoqëruar me vërtetimin hipotekor të regjistrimit; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 19.07.2004, shoqëruar me vërtetimin hipotekor, si dhe hartën treguese të regjistrimit; deklaratë noteriale nr. [***] rep., [***] kol., datë 24.06.2004; praktika dokumentare e administruar nga ZVRPP Durrës, me shkresën nr. [***], datë 06.12.2016, mbi pas. nr. [***], vol. [***], f. [***], z. [***]; certifikatë për vërtetim nr. [***], shoqëruar me skiçin; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 29.10.2005; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 29.10.2005; kontratë shitblerjeje automjeti nr. [***] rep., [***] kol., datë 21.11.2006; kontratë shitblerjeje automjeti nr. [***] rep., [***] kol., datë 15.01.2008; kontratë shitblerjeje automjeti nr. [***] rep., [***] kol., datë 26.05.2017; vendim nr. [***], datë 17.12.2008, i Zyrës Rajonale për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave Qarku Durrës; kontratë huaje nr. [***] rep., [***] kol., datë 07.07.2010; deklaratë noteriale nr. [***] rep., [***] kol., datë 01.12.2011; deklaratë noteriale nr. [***] rep., [***] kol., datë 07.09.2011; kontratë qiraje nr. [***] rep., [***] kol., datë 05.05.2011; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 2.12.2011, shoqëruar me vërtetimin hipotekor; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 05.04.2012, shoqëruar me vërtetimin hipotekor, si dhe planimetrinë përkatëse; pasqyrat e lëvizjeve monetare në llogarinë e klientit, z. N.G., në [***]; pasqyrat e të dhënave financiare mbi klientin N.G., të nxjerra nga dokumentacioni kontabël i shoqërisë “[***]” ShPK; kontratë shitblerjeje nr. [***] rep., [***] kol., datë 09.01.2013; kontratë huaje, datë 30.01.2013, me palë huadhënëse z. E.S. dhe z. K.S. dhe palë huamarrëse z. N.G.; kontratë premtim shitjeje për pasuri të paluajshme truall + godinë nr. [***] rep., nr. [***] kol., datë 28.01.2013, bashkëlidhur dy vërtetime hipotekore, si dhe planimetritë; formular vetëdeklarimi i z. K.S., lidhur me objektin shtëpi banimi tri kate + magazinë; kërkesë për legalizimin e ndërtimit pa leje të kapononit 2500 m²; leja e legalizimit nr. [***] në emër të z. N.G., bashkëlidhur planimetria; certifikatë për vërtetim pronësie, lidhur me pas. nr. [***], vol. [***], f. [***], me adresë lagjia [***], [***], shoqëruar me hartën treguese të regjistrimit dhe kartelën e pasurisë; certifikatë për vërtetim pronësie, lidhur me pas. nr. 5/2922/ND, vol. 13, f. 146, me adresë lagjia 14 Shkozet, shoqëruar me hartën treguese të regjistrimit dhe kartelën e pasurisë; preventive punimesh lidhur me objektin kaponon në pronësi të z. N.G., i kryer nga shoqëria [***] në bazë të VKM-së nr. 568, datë 27.06.2013, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”; praktikë dokumentare për ndërtimin e një kapononi për llogari të shoqërisë [***] me sip. 2050 m², praktikë e cila shërben si referencë për përcaktimin e vlerës së ndërtimit të kapononit të ngjashëm me të, në pronësi të z. N.G.; deklaratë noteriale nr. [***] rep., nr. [***] kol., datë 15.12.2013, së bashku me pasqyrat e llogarisë bankare të klientit, z. N.G., të marra së bashku nga [***], mbi pagesën e interesave të shumës së marrë hua; kontratë qiraje nr. [***] rep., [***] kol., datë 05.05.2011; kontratë qiraje nr. [***] rep., [***] kol., datë 14.05.2014; kontratë qiraje nr. [***] rep., [***] kol., datë 14.04.2016; kontratë qiraje nr. [***] rep., [***] kol., datë 22.07.2016; kontratë qiraje nr. [***] rep., [***] kol., datë 19.01.2016, shoqëruar me certifikatën e vërtetimit të pronësisë, së bashku me planimetrinë; kontratë qiraje nr. [***] rep., nr. [***] kol., datë 22.01.2016; kontratë qiraje nr. [***] rep., nr. [***] kol., datë 22.01.2016, në gjuhën italiane; kontratë qiraje nr. [***] rep., nr. [***] kol., datë 03.02.2017; kontratë qiraje nr. [***] rep., nr. [***] kol., datë 3.2.2017; kontratë qiraje nr. [***] rep., [***] kol., datë 31.1.2018; kontratë qiraje nr. [***] rep., nr. [***] kol., datë 31.1.2018, në gjuhën italiane, shoqëruar me certifikatën e vërtetimit të pronësisë; pasqyrat e lëvizjeve monetare në llogarinë e klientit, z. N.G., në [***] për periudhën 07.06.2006 - 02.07.2018, lidhur me konformat bankare për pagesën e qirave; praktika dokumentare e pas. nr. [***] vol. [***], f. [***], z. [***], e administruar nga ZVRPP Durrës, me shkresën nr. [***] prot., datë 20.08.2018; praktika e kontratës së qirasë financiare, konfirmuar zyrtarisht nga banka “[***]”, me shkresën nr. [***] prot., datë 16.07.2018; akti i ekspertimit ekonomiko-financiar të subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi; akti i ekspertimit ekonomiko-financiar të z. N.G.; certifikatat e sigurisë së subjektit të rivlerësimit Rovena Gashi”.

²¹ Shih aktet: “Dëftesa postare mbi kërkimin e provave tek institucionet shtetërore prej subjektit të rivlerësimit Rovena Gashi”.

²² Shih aktet: “Raporti mjekësor nr. [***] regj., datë 18.07.2018; deklaratë noteriale nr. [***] rep., [***] kol., datë 07.09.2018, e znj. Sh.V.; deklaratë noteriale nr. [***] rep., [***] kol., datë 07.09.2018, e znj. M.L.; deklaratë noteriale nr. [***] rep., [***] kol., datë 11.09.2018, e z. A.Xh.”.

24. Sipas gjetjes së vëzhgueses ndërkombëtare, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur së bashku me ankimin një raport mjekësor, të lëshuar më datë 18.7.2018, dokument i cili tregon paaftësinë në punë të saj për periudhën 19.07.2018 - 02.08.2018, por ky raport nuk është paraqitur asnjëherë pranë Komisionit dhe nuk është administruar si provë, as si akt, as si pretendim për shtyrje të seancës dëgjimore publike. Nëse do të ishte paraqitur përpara seancës dëgjimore, ai do të kishte çuar pa asnjë dyshim në vendimmarrje për shtyrjen e seancës publike. Më datë 20.07.2018, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka paraqitur personalisht mbrojtjen (deklaratën përmbyllëse) me shkrim të subjektit të rivlerësimit, pranë protokollit të Komisionit, në orën 09:11, por nuk është paraqitur asnjë raport mjekësor, dhe kjo gjetje konfirmohet nga faqja përkatëse e regjistrit të protokollit të Komisionit, që është vënë në dispozicion të Kolegjit të Apelimit nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (në vijim “ONM”). *E-mail*-i i subjektit të rivlerësimit i orës 09:29, dërguar në adresën info@kpk.al, përmbante vetëm deklaratën e saj mbrojtëse dhe ai nuk u referohej kushteve të pretenduara të saj mjekësore apo një raporti mjekësor. Madje kjo deklaratë përmbyllëse nuk qe shoqëruar me kërkesë për shtyrje të seancës publike, me objektiv paraqitjen personalisht të subjektit. Subjekti gjithashtu nuk ka bërë asnjë kërkesë ndaj Komisionit, për shtyrje të seancës publike për shkakun se koha për përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare, sipas pretendimit të saj, ishte e shkurtër, apo e pamundur për të gjetur dhe një mbrojtës ligjor, në ndihmë të përgatitjes së konkluzioneve përfundimtare. Kjo gjetje konfirmohet nga teksti i *e-mail*-it që ONM ka marrë nga Komisioni, të cilin ia ka vënë në dispozicion KPA-së, bashkëlidhur kësaj gjetjeje. Në mungesë të një kërkesë të tillë nga subjekti për shtyrje të seancës, shoqëruar me akte, për shkaqet e mësipërme, nuk e obligonte proceduralisht Komisionin që të mos e zhvillonte këtë seancë në ditën dhe orën e caktuar dhe të komunikuar subjektit. Pra, seanca gjyqësore publike është zhvilluar, në respektim të plotë të dispozitave përkatëse të ligjit nr. 84/2016, që rregullojnë këtë procedurë, dhe dispozitave bazike të K.Pr.Civile për gjykimin në mungesë.

Ç. Në lidhje me kundërshtimin e vendimeve të ndërmjetme

25. Trupi gjykues i Kolegjit çmoi se është i pabazuar në ligj dhe në prova, kundërshtimi i vendimit të datës 20.06.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për sa më poshtë.
- i) Vërehet se në dosjen e Komisionit janë administruar dy vendime të numërtuara me të njëjtin numër dhe që mbajnë datën 20.06.2018, nëpërmjet të cilave Komisioni ka vendosur mospranimin e kërkesës së subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi, për përjashtimin e saj nga lista prioritare, por se ndryshimi midis këtyre vendimeve qëndron në argumentin e shtuar të Komisionit se “nuk ka bazë ligjore që të legjitimojë subjektin e rivlerësimit për këtë kërkesë dhe që t’i diktojë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për të hequr subjektin nga lista prioritare”, përveç argumentit se procedura e hetimit administrativ ishte në fazën konkluzive dhe për ekonomi procedurale nuk mund të pranohej.
 - ii) Nuk qëndron kundërshtimi i kompetencës së trupit gjykues të Komisionit, pasi Komisioni ushtron funksionet administrative nëpërmjet Mbledhjes së Komisionerëve dhe funksionin e shqyrtimit të çështjeve që i përkasin juridiksionit të rivlerësimit, nëpërmjet trupave gjyqësore të zgjedhura me short dhe, për këtë arsye, për shkak të natyrës së ndryshme të kompetencave përkatëse, si dhe ekskluzivitetit të ushtrimit brenda juridiksionit respektiv, nuk është e mundur përplasja midis tyre.

- iii) Nga ana tjetër, kompetenca për shqyrtimin e çështjeve që i përkasin juridiksionit të rivlerësimit, përcaktohet nga fakti dhe ligji i zbatueshëm në momentin e fillimit të procesit dhe nuk ndikohet nga ndryshimet e mëvonshme të këtyre të fundit. Fakti i qenies subjekt prioritar, në momentin e fillimit të procedurës ka qenë në përputhje me ligjin, ndërkohë që nuk kishte bazë ligjore për të pezulluar këtë shqyrtim, për shkak të mosqenies subjekt prioritar. Nga ana tjetër, vendimi i kundërshtuar i Komisionit është i natyrës së ndërmjetme, që i jepte mundësi Komisionit për ta rishikuar, pa cenuar të drejtat procedurale të subjektit të rivlerësimit.

25.1 Trupi gjykues i Kolegjit çmon se është i pabazuar në ligj dhe në prova, kundërshtimi i vendimit të datës 04.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për sa më poshtë.

- i) Rastet e paanësisë përcaktohen nga neni 27 i ligjit nr. 84/2016, me referim në ligjin nr. 9367, datë 7.04.2005, “Mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe nenin 30 të K.Pr.Administrative, dhe kryerja e veprimeve procedurale nga ana e Komisionit nuk përcaktohet si shkak për të pretenduar paanësinë e anëtarëve të trupit gjykues.
- ii) Shprehimisht, neni 1, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, përcakton se “persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi, ndërsa neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 përcakton: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.
- iii) Nga faktet që rezultojnë nga deklarata noteriale e sipërcituar, nr. {***} rep., nr. {***} kol., e cituar më sipër, dhe nga shkresa nr. {***} prot., datë 11.01.2018, e {***} rezulton se në datën 24.08.2017, z. N.G. ka kryer pagesën e shkollimit për K. dhe O.G., në shumën 4000 euro, dhe në datë 4.01.2018, z. N.G. ka kryer pagesën e shkollimit për K. dhe O.G. në shumën 3000 euro. Bazuar në këto fakte dhe në nenin 1, pika 14 dhe nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, konfirmohet se z. N.G. është person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe mbartës i detyrimit për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive dhe, për këtë arsye, konfirmohet marrëdhënia me z. N.G..

25.2 Trupi gjykues i Kolegjit çmon se është i pabazuar në ligj dhe në prova, kundërshtimi i vendimit të datës 06.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për sa më poshtë.

- i) Rivlerësimi për subjektin e rivlerësimit është përmbyllur me rezultate për: i) apartament banimi, me sipërfaqe 105 m² në {***}, Durrës; ii) apartament me sipërfaqe 121 m², në rrugën “{***}”, Tiranë; iii) analizën financiare të subjektit të rivlerësimit; dhe iv) zgjerimin e hetimit mbi burimet financiare të ligjshme të babait të subjektit të rivlerësimit, z. N.G.; dhe Komisioni nuk e ka bazuar vendimmarrjen në procedurat e figurës dhe aftësive profesionale, pasi ka vlerësuar të bazojë vendimin përfundimtar në kriterin e pasurisë, sipas përcaktimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, kriter për të cilin edhe i ka kaluar barra e provës. Nga materialet e dosjes, vërehet se subjekti i rivlerësimit ka nënshkruar deklaratën e datës 27.06.2018, pasi është njohur dhe ka marrë nga dosja e administruar nga Komisioni, të gjithë dokumentacionin e kërkuar, duke përfshirë edhe raportin mbi kontrollin e figurës të DSIK-së, pjesërisht i deklasifikuar, si dhe raportin e vlerësimit profesional të Prokurorisë së

Përgjithshme dhe, për këtë arsye, pretendimi për t'u njohur me aktet, bazuar në këto të dhëna, është i pabazuar.

- ii) Në lidhje me mosaplikimin e standardeve, parimeve, procedurave dhe metodologjive të barabarta me subjektet e tjera të përfshira në të njëjtën procedurë vlerësimi, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i caktuar për shqyrtimin e vendimit të Komisionit, vlerëson se barazia para ligjit është një e drejtë themelore, e përcaktuar nga neni 18 i Kushtetutës, por pretendimi për mosaplikim të standardeve, parimeve, procedurave dhe metodologjive të barabarta me subjektet e tjera të përfshira në të njëjtën procedurë vlerësimi, është i pabazuar, nuk provohet si pretendim në asnjë akt apo veprim procedural të Komisionit në raport me subjektin.

25.3 Trupi gjykues i Kolegjit çmon së është i pabazuar në ligj dhe në prova, kundërshtimi i vendimit të datës 11.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në lidhje me mosnjoftimin e trupit gjykues të Komisionit dhe të relatorit, trupi gjykues i Kolegjit të Apelimit vlerëson se ai është i pabazuar, pasi me vendimin e datës 15.03.2018 të trupit gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me përbërje komisionerët Alma Faskaj, Brunilda Bekteshi dhe Valbona Sanxhaktari, është pranuar kërkesa për dorëheqje e komisioneres/relatore Suela Zhegu, duke u vendosur përfundimisht zëvendësimi i kësaj komisionereje nga procesi i rivlerësimit për subjektin Rovena Gashi. Nga komunikimi elektronik i datës 12.06.2018, me lëndë "Njoftim nga Komisioni", drejtuar znj. Rovena Gashi, vërehet teksti: "bashkëngjitur këtij *e-mail*-i, do të gjeni njoftimin mbi përbërjen e trupës së KPK-së për rivlerësimin tuaj". Në rastin konkret, nuk është hedhur short i ri, por relatoren e përjashtuar e ka zëvendësuar anëtari zëvendësues, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016. Kjo rrethanë nuk sjell ndonjë fakt të ri për të njoftuar subjektin e rivlerësimit, por një veprim procedural bazuar në faktin ekzistues, sipas parashikimit ligjor. Të drejtën e njohjes për faktin ekzistues, subjekti i rivlerësimit mund ta ushtronte qysh në fillim të procesit të rivlerësimit në ngarkim të tij. Megjithatë, mosnjohja e përbërjes së trupit gjykues lidhet me lindjen e së drejtës për të kundërshtuar anëtarin, por jo domosdoshmërisht me njëanshmërinë e trupit gjykues.

25.4 Trupi gjykues i Kolegjit çmon së është i pabazuar në ligj dhe në prova, kundërshtimi i subjektit ndaj vendimit të datës 09.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për sa më poshtë.

- i) Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se i është mohuar e drejta për t'u administruar dhe shqyrtuar nga Komisioni i 38 akteve dhe me këtë veprim Komisioni i ka hequr të drejtën e barrës së provës dhe realizimin e një mbrojtjeje efektive, Kolegji çmon se vendimi i ndërmjetëm i Komisionit, i datës 09.07.2018, është i argumentuar me bazë ligjore dhe analizë provash, në rastin kur është çmuar se këto prova janë të panevojshme, nuk sjellin asnjë fakt juridik në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Në vijim të sa më sipër, Komisioni ka definuar në vendim se kjo çështje mund të zgjidhej me atë numër provash të analizuar dhe të administruar prej tij, për të cilat subjekti ka pasur dijeni të plotë. Për sa i përket kërkesës së subjektit ndaj Komisionit, datë 07.07.2018, për kryerjen e veprimeve të tjera procedurale, duke i kërkuar atij (Komisionit) marrjen e këtyre provave shkresore, nga institucione shtetërore dhe subjekte të tjera private, si dhe marrjen e dëshmimeve për të vërtetuar marrëdhënie juridike që ligji kërkon shkresë (faktin e administrimit të pallatit, faktin e të qenit banor i pallatit), ishte në një kohë që Komisioni kishte vlerësuar se provat e grumbulluara arrinin nivelin e provueshmërisë për disponimin përfundimtar në lidhje me

kriterin e pasurisë. Nga Kolegji, çmohet se kjo kërkesë me të drejtë nuk është pranuar nga Komisioni, pasi mundësia për të paraqitur prova gjatë procesit të rivlerësimit ka qenë e plotë dhe aspak provuese për të drejtat procedurale në proces të subjektit. Aq më tepër që zgjidhja përfundimtare është konkluduar me aktet e mjaftueshme të administruara në këtë proces dhe për të cilat subjekti ka pasur dijeni të plotë.

- ii) Ankuesit i ka kaluar barra e provës në datën 26.06.2016, ndërkohë që është vënë në lëvizje për të dërguar shkresa në institucionet e përmendura në datën 07.07.2018, sikurse rezultojnë nga mandatet postare. Në bazë të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e krijimit të pasurive.

Bazuar në nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe 45, pika 1 dhe 47 të K.Pr.Administrative, palët gjatë procesit administrativ në Komision kanë të drejtën e aksesit me dosjen, pra të njihen me dokumentet e administruara në të, si dhe të marrin kopje dhe madje në çdo fazë të procedurës të paraqesin shpjegime në lidhje me ato fakte të rezultuara nga këto prova, gjithnjë të lidhura me objektin, rrethanat apo çështjet ligjore që lidhen me objektin e hetimit dhe procedurës administrative. Subjekti në këtë proces ka të drejtë të paraqesë prova dhe propozime për zgjidhjen e çështjes. Në rastin objekt gjykimi dhe tashmë ankimimi subjektit i janë garantuar këto të drejta dhe nuk ka asnjë provë që të provojë të kundërtën, privimin e këtyre të drejtave.

- iii) Në lidhje me pretendimin e ngritur për t'u thirrur si dëshmitar dhe për t'u pyetur në këtë cilësi z. N.G. dhe persona të tjerë, K.Pr.Civile ka vendosur kufij për lejimin e provave me dëshmitarë, sikurse neni 231 i K.Pr.Civile përcakton se prova me dëshmitarë lejohet në të gjitha ato raste, përveç kur ligji për vlefshmërinë ose për provimin e një veprimi juridik kërkon shkresë. Komisioni bazuar në nenin 49 të ligjit nr. 84/2016, e konsideroi identifikimin e fakteve, për të cilat kërkohej marrja e provave, jo në përputhje me faktet që ishin objekt rivlerësimi dhe gjithashtu të parëndësishme për vendimmarrjen. Trupi gjykues e çmon të bazuar këtë vendimmarrje.

25.5 Trupi gjykues i Kolegjit çmon së është i pabazuar në ligj dhe në prova, kundërshtimi i vendimit të datës 11.07.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për sa më poshtë.

- i) Në lidhje me pretendimin për pezullimin e shqyrtimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar prej GjEDNj-së, rezultojnë nga shkresa {***} mod. {***}, datë 20.06.2018, e GjEDNj-së në lidhje me aplikimin nr. {***}, Gashi dhe Gina kundër Shqipërisë, nga kjo gjykatë vërehet se aplikuesit kërkojnë nga GjEDNj, bazuar në nenin 39 të rregullores së gjykatës, t'i kërkojë në mënyrë urgjente qeverisë shqiptare të revokojë urdhrat e pezullimit dhe të rikthejë kërkesit në detyrën e prokurorëve dhe zbatimin e neneve 40 dhe 41 të rregullores së gjykatës në lidhje me aplikimin e paraqitur. Çështja që pretendohet të gjykohet nga GjEDNj-ja, vërehet se i përket juridiksionit të zakonshëm të llogaridhënies, përkatësisht pezullimit nga detyra të prokurorit.

- ii) Në bazë të nenit 32 të KEDNj-së, juridiksioni i gjykatës shtrihet mbi të gjitha çështjet që lidhen me interpretimin dhe zbatimin e Konventës dhe të protokolleve që i referohen asaj, siç parashikohet në nenet 33, 34 dhe 47, duke përjashtuar nga juridiksioni i saj interpretimin dhe zbatimin e ligjit kombëtar. Nga ana tjetër, neni 297 i K.Pr.Civile përcakton: "Gjykata vendos pezullimin e gjyqimit kur: a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një

çështje tjetër penale, civile ose administrative; b) kërkohet nga të dyja palët; c) njëra nga palët vdes ose mbaron personi juridik; ç) njëra nga palët nuk ka ose më vonë ka humbur zotësinë juridike për të vepruar si palë dhe shihet e nevojshme t'i emërohet një përfaqësues ligjor; d) parashikohet shprehimisht në ligj; dh) njëra nga palët paraqet kërkesën për zgjidhje të çështjes me ndërmjetësim dhe gjykata e vlerëson të arsyeshme.”

- iii) Çështja e regjistruar në GjEDNj, që i përket një juridiksioni të ndryshëm nga juridiksioni i rivlerësimit, lidhet me interpretimin dhe zbatimin e KEDNj-së dhe të protokolleve që i referohen asaj, dhe ajo nuk përbën parakusht për zgjidhjen e çështjes së paraqitur para institucioneve të rivlerësimit, përkundrazi ajo i përket juridiksionit të zakonshëm që gjithsesi nuk ka përparësi para juridiksionit të posaçëm të rivlerësimit (*lex specialis*).

25.6 Trupi gjykues i Kolegjit çmon së është i pabazuar në ligj dhe në prova, kundërshtimi i vendimit të datës 11.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për sa më poshtë.

- i) Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2/2017, ka arritur në përfundimin se dispozitat e ligjit garantojnë aksesin në të gjithë informacionin e dokumentet e disponuara nga grupi i punës dhe garantojnë kontrollin efektiv mbi veprimtarinë e grupeve të punës nga Komisioni. Organet e tjera, të cilat janë të përfshira në procesin e rivlerësimit, kanë funksione ndihmëse, që kanë për qëllim të ndihmojnë institucionet kushtetuese në përmbushjen e mandatit të tyre. Në të gjitha rastet, autoriteti vendimmarrës mbetet tek organet e rivlerësimit, të krijuara për këtë qëllim, në përputhje me dispozitat e Kushtetutës, si organe gjyqësore të pavarura dhe të paanshme.
- ii) Por, për këtë subjekt rivlerësimi, procesi i rivlerësimit ka përfunduar me vendimmarrje përfundimtare vetëm për procedurën e kontrollit të pasurisë, ndërkohë që nuk ka arritur në një vendimmarrje përfundimtare për kontrollin e figurës, sikurse nuk ka arritur në një vendimmarrje përfundimtare për vlerësimin e aftësive profesionale. E thënë ndryshe, procedura e kontrollit të figurës ka filluar sipas ligjit, janë kryer edhe veprimet ndihmëse sipas ligjit, por nuk i është nënshtruar shqyrtimit përfundimtar nga Komisioni dhe as ka ndikuar në vendimmarrjen përfundimtare, në mënyrë që të jenë përcaktuar të drejtat për këtë kriter.

25.7 Trupi gjykues i Kolegjit çmon së është i pabazuar në ligj dhe në prova, kundërshtimi i vendimit të njoftuar në datën 19.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në lidhje me procedurat e kryera nga komisionerja Suela Zhegu, rezulton se hetimi administrativ është mbyllur me vendimin e datës 20.06.2018, që përkon me një periudhë kohore prej më shumë se 3 (tre) muajsh nga zëvendësimi i relatores, dhe vendimmarrja për çdo veprim procedural pas zëvendësimit të relatores, i takon trupit gjykues të shortuar për këtë subjekt rivlerësimi, i cili është i pavarur në vendimmarrjen e tij dhe garanton pavarësinë sipas përcaktimit të nenit 27 të ligjit nr. 84/2016.

25.8 Trupi gjykues i Kolegjit çmon së është i pabazuar në ligj dhe në prova, kundërshtimi i vendimit të njoftuar në datën 19.07.2018 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për sa më poshtë.

- i) Në lidhje me pretendimin se trupi gjykues i Komisionit ka mohuar të drejtën e hetimit të plotë dhe të gjithanshëm e të barabartë me subjekte të tjera të rivlerësimit dhe të drejtën për një mbrojtje efektive dhe sipas një afati të arsyeshëm në seancë dëgjimore, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar të drejtën për të paraqitur prova të reja, por ka kërkuar

nga Komisioni kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore dhe mbledhjen e provave të reja nga vetë Komisioni. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se kjo kërkesë nuk është në përputhje me parashikimet e nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në të cilën parashikohet se subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova.

- ii) Pretendimit në ankim se i është mohuar e drejta e mbrojtësit, për shkak të afatit të pamjaftueshëm, vërehet se subjekti i rivlerësimit ka qenë aktiv gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, dhe çdo veprim procedural e ka kryer personalisht, dhe duke mos përzgjedhur mbrojtës ka ushtruar çdo të drejtë procedurale që ka çmuar në interes të mbrojtjes. Për më tepër, në datën 20.7.2018, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën përmbyllëse ku pozicionohet për zgjidhjen në themel të çështjes dhe pa i bërë prezente Komisionit pamundësinë për të zgjedhur një mbrojtës dhe as kërkesë për shtyrjen e seancës deri në zgjedhjen e një mbrojtësi.

25.9 Trupi gjykues i Kolegjit çmon se është i pabazuar në ligj dhe në prova, kundërshtimi i vendimit të datës 07.08.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në lidhje me kërkesën për pavlefshmëri absolute të vendimit përfundimtar të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit të Apelit vlerëson se trupat gjykuese të Komisionit nuk kanë kompetenca për të ushtruar kontroll mbi vendimet përfundimtare të dhëna prej atyre vetë, pasi bazuar në nenin 31, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelit, sikurse Komisioni nuk ka në objektin e veprimtarisë së tij kontrollin e vlefshmërisë së kushteve dhe kërkesave për të qenë komisioner.

- 26. Në përfundim të shqyrtimit të vendimit nr. 48, datë 25.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit nuk konstaton shkelje procedurale të tilla që ta bëjnë të cenueshëm vendimin e Komisionit. Në funksion të rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Komisionit, i cili ka garantuar paanësinë e tij, ka konstatuar saktësisht dhe plotësisht provat e administruara gjatë një procesi të zhvilluar publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm, mjaftueshëm për të mbështetur një vendimmarrje të drejtë.
- 27. Pas marrjes në shqyrtim të shkaqeve të ankimit dhe vlerësimit të provave, trupi gjykues i Kolegjit të Apelit çmon se subjekti i rivlerësimit ka në pronësi pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht; deklarimi për këto pasuri është kryer në mënyrë të pasaktë dhe të paplotë; dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, bazuar në përcaktimet e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 33, pika 5, germa “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

27.1 Për pasurinë apartament te “{***}”, Durrës, trupi gjykues çmon se:

- i) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë dhe të paplotë këtë pasuri të paluajtshme, bazuar në përcaktimet e nenit D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016
- ii) subjekti i rivlerësimit ka pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht dhe nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave për të fituar këtë pasuri, siç përcaktohet në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

27.2 Për pasurinë apartament në ish-rrugën “{***}” Tiranë, trupi gjykues çmon se:

- i) subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në mënyrë të pasaktë dhe të paplotë këtë pasuri të paluajtshme, bazuar në përcaktimet e nenit D, pikat 1 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016
- ii) subjekti i rivlerësimit ka pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht dhe nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave për të fituar këtë pasuri, siç përcaktohet në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

27.3 Trupi gjykues çmon se nga analiza financiare rezultoi që subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të aftësive paguese me të ardhura nga burime financiare të ligjshme, siç është konkluduar në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, situatë faktike që parashikohet në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 48, datë 25.07.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Rovena Gashi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 29.05.2019.

ANËTAR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATOR

Luan DACI

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi